
GJON BUZUKU



Revistë informative, kulturore e shoqërore
Ulqin, e hëne më 21 prill 2014   Çmimi 1Ä
numër 41

Arbërit e Malit të Zi të sotëm gjatë mesjetës
faqe 8

Ullinjtë e shenjtë po na gëzohën
faqe 9

Besa e Konstantinit të Madh
faqe 17

Gjuha arbëreshe - dita e gjuhavet*

Shkruan **Pino Cacozza**, Arbëresh (Shqiptar) prej Italisë, pinocacozza@arbitalia.it, www.arbitalia.it

Në gjuhën arbëreshe

Mirëdita Dheu im, Dheu i gjithve.
Sot 21 shkurt 2014 është dita internacjonale të gjuhavet, festohet Gjuha Mëmë, Arbërishtja ime.
Fjala na bashkon, o vëllezer.
Kudo gjëndemi, tingulli na lidhen njerin me jetrin pa u njohur fare.
Fati na shprishi e jemi të ndarë, por një fill i padukshëm na shton. Është filli i shpirtit arbëror, atje ku afër o larg thomi bukë, thomi kripë e thomi zëmër.
Mendimi jep emocjion.
Shkrujta një poezi e re dhe kam dëshirë t' e ndanj me ju.

GJUHA MËMË

Sa bukur është kur fjet arbërisht,
thue *mëmë*, thue *at*, thue *biri im*,
zëmra këndon e, vazhdimisht,
vala çë del të sjell paq' e gëzim.
Kur je bashkë bular të mban,
kur je vet nga trëmbja të mbron,
të mbjedh e të puthen kur qan
e kur ule të shtyn e të shton.
Është *Gjuha e Mëmës*, i pari mall,
tingulli i fatit çë të përsjell,
çë kur u leve e njera çë rri,
fuqia çë gjen, ylli ndër ball,
drita e agimit çë të pjell,
melodia e trurit, dashuri.

Në gjuhën italiane

Buongiorno Mondo mio, Mondo di tutti.
Oggi 21 febbraio 2014 è la giornata internazionale delle lingue, si festeggia la Lingua Madre, la mia lingua arbëreshe.
La parola ci unisce, fratelli.
Ovunque ci troviamo, il suono ci unisce l'un l'altro senza conoscerci affatto.
Il destino ci ha sparsi e siamo divisi, ma un filo invisibile ci ricongiunge. È il filo dello spirito albanese, là dove vicini o lontani diciamo pane, diciamo sale, diciamo cuore. Il pensiero emoziona.
Ho scritto una poesia nuova e ho desiderio di condividerla con voi.

Quant'è bello parlare albanese,
dici *mamma*, dici *padre*, dici *figlio*,
il cuore canta e, continuamente,
l'onda che esce ti porta pace e gioia.
Quando sei insieme fiero ti tiene,
quando sei solo ti protegge,
quando piangi ti accoglie e ti bacia
e quando siedi ti sospinge e ti unisce.
È la *Lingua della Madre*, primo amore,
il suono del fato che t'accompagna,
da quando sei nato e fino al tuo stare,
la forza che trovi, la stella in fronte,
la luce dell'alba che ti partorisce,
la melodia della mente, amore.

Në gjuhën shqype të Ulqinit

Mirdita Dheu jem, Dheu i gjidhve.
Sot 21 shkurt 2014 isht dita e t'gjitha gjuhve n'botë, festohet Gjuha Nansë, Shqypja jeme.
Fjala na bashkon, o vllazën.
Kudo qi gjinemi, fjala shqype na lidhen njanin me tjetrin fare pa u njothtë.
Fati na shpërdau, e jena t'damë, por nji fije e padukshme na bashkon. Isht fije e shpirtit shqyptarë, atje ku jena afër o larg, thona bukë, thona krypë e thona zemër.
Menimi na shtynë me u përmallue.
Shkrova nji kangë t're dhe kam dishirë ta danj me ju.

GJUHA NANSË

Sa bukur isht kur flet shqyp,
thue *nanë*, thue t*atë*, thue *biri jem*,
zemra knon e, si tallazet e detit pa u nalë, t'sjellin paq' e gzim.
Kur je me shokë, t'ban krenarë; kur je vetëm t'ruen pej friget; t'lurton e t'puthën kur kjanë; e kur nalohe t'nep zemër.
Isht *Gjuha e Nansë*, i pari përmallim, zani nafaksë qi t'përcjell, çe ke le e deri sot, fuqinë qi e gjien, ylli n'ballë, drita e natjes qi t'çon pej gjumit, rahatija e menjes, e dashnija.

***Pak histori**

Në shekullin XV, gjatë pushtimit turk, rreth 200 mijë shqiptarë e lëshuan vendin e vet dhe zunë vend më të shumtën në Italinë e jugut. Pra, kaluan afër 600 vite prej se shqiptarët (arbëreshët) erdhën në Itali. Ata sot e kësaj dite po e ruajnë gjuhën e nanave arbëreshe (shqiptare), çka shihet në shkrimin sipër.
E na shqyptartë n'Mal t'Zi po e hupim gjuhën e nanave n'oborrin e vet!

Komentoi S.Gj.Dobreci

Redaktorit t'revistës BUZUKU

Shkruen **Gjergji Leks Macit Kols Perkolonj** (Perkoliq), Shestanas, Te-Pleva, Fusha e Tivarit

Zotni redaktor,
Para do kohet kam shkruo për panreqsi qi i bánë Shestanit n'konferencën qi asht májtë n'Ulqin më 2011, ku ju kini botuo referatat n'librin KRAJA ME VEÇANTITË SHESTANASE... N'referatin e Edmond Malaj n'faqen 98 shkruon kshtu: Shestanasit bashkuo me malazez kanë shkuo n'Shkodër më 1913, kanë grabitë truporen e Shen Gjergjit lle e kanë venuo n'kishën e Shnanout në Nrekaj (Karanikiq). Jam i binun, nji intelektual munet me shkruo kso t'pavërtetash (rrena).
Pej bije shkurt. N'luftën n'Torobosh, shum Shestanas janë mobilizuo pej kral Nikollës; masi n'atë luft, ku jan bjerrë shum malazez, nuk asht bjerr asnjë shestanas, si shpërblim, se i ka ruojtë Shnjergji, truporën e tij e kanë pru pej Italijet mas luthtet me organizimin e nimën e patër Stakës, pritht taljan me detyrë n'kishën e Nënmalit. T'gjill shestanas kanë nimuo me pare.
Truporja ko kijen Shëngjergji mé kálit me heshtën, si lle kulçedra. Truporja ko kijen pej gipsit e forcuome me rrjetë hekurit. E ko damtuo termeti.
Për fat t'keq, páshë qi elle ju kini kundërshtar pej sish qi kini punuo me ta; nër ta asht i deshpruom elle Gjergj Kola - Pepgjoni, se Dr Sima ká autoritet má shum se ata.
Para dy javësh kijesh n'Ulqin. Páshë ata qi s'kam po tash 70 vjet: Myslimane e vishun me ferexhe si lle ftyrën e mlume me zarë. I kam shkrua Nail Dragës, n'Tiranë Malaj lle Gjokë Dabës, por as njani nuk asht pëgjegjë.
Tivar, më 16.11.2013.

PËRMBAJTJA

2. Gjuha arbëreshe - Dita e gjuhavet
2.Redaktorit t'revistës BUZUKU
3.Sa na duan të tjerët
4.Keqpërdorimet si me program shkatërrues
6.Veshja popullore e Krajës
7.Nga katundet Arbëreshe
8.Arbërit e Malit të Zi të sotëm gjatë mesjetës
9.Ullinjtë e shenjtë po na gëzohën
10. Festa e gështenjave në Krajë
11. Qafa e kishës – Spinjë
12.BUZUKU – numri jubilar 40
13. Revista BUZUKU, arkiv në miniaturë
14. Revista BUZUKU - përurohet numri 40
15.Ëndrra e gucianëve u realizua
16. Varrezat Misterioze
17. Besa e Konstantinit të Madh
18. Thesar i çmuar në zhanrin e biografisë
18. Maratona për Ditën e Flamurit
19. Shoqatë që punon shumë
20. Poezi
21-22. Popullore
23. In memoriam - Nikolla Niloviq
23. Edith Durham për ballkanasit
24. Shqiptari në Librin e Ginisit

GJON BUZUKU 41

REVISTË
INFORMATIVE, KULTURORE
E SHOQËRORE

Kryeredaktor:
Prof. dr. Simë Gjon Dobreci

Ndihmës të kryeredaktorit
Msc Anton Lulgjuraj

Anëtarët e redaksisë:
Prim.dr. Gani Karamanaga,
Dr. Zylfije Duraku, dr. Lukë Gjokaj, Dr Nail Draga,
Gjokë Dabaj, Hajro Ulqinaku, Ali Gjeçbritaj,
Muzafer Çaushi, Mustafa Canka

Fotoshërbimi:
Foto Studio Ars, Foto Rozafa, Foto Arb, Art Foto
Prishtinë, Foto Bruno
Realizimi artistik:
Fisnik Dobreci & Gazmend Çitaku

Adresa e redaksisë:
Braticë
85360 ULQIN
Nr.tel. ++382 (0) 30 401-384, 069 441-943
www.buzuku.info
E-mail: fdobreci@t-com.me

Numri i llogarisë rrjedhëse
Banka komerciale malazeze A.D.
Ekspozitura Ulqin Nr. 510-0-40
Thirrje ne Nr. 510270393491001825

Me vendimin e Ministrisë të Punëve të Brendshme
të Malit të Zi, Podgoricë, nr.05-006/12-20622/2,
revista e regjistruar në nr. 6308, më 13.02.2014

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Të nderuar lexues dhe bashkëpunëtorë,

Në tubimin e anëtarëve të redaksisë të revistës BUZUKU, të pranishmit ishin të mendimit që numri i anëtarëve të redaksisë të zvogëlohet, si dhe revista BUZUKU të regjistrohet në kuadër të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi, çka dhe u pranua. Në mbledhjen e anëtarëve të redaksisë të Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë, kryetar prim. dr Gani Karamanaga, u vendos të vazhdojë botimi i revistës periodike me emër "Gjon BUZUKU", e cila do të jetë vazhdimësia e revistës "BUZUKU", gjegjësisht "BUZUKU-b", ku kryeredaktor është prof. dr Simë Gjon Dobreci prej fillimit të botimit të saj më 2001. Simë Gjon Dobreci propozoi dy anëtarë të ri të redaksisë, kurse tjerët u propozuan nga të pranishmit në këta dy takime. Për shpjegim pse u veprua kështu, të interesuarit mund tu drejtohen anëtarëve të redaksisë.
Besojmë që do të kemi mirëkuptim të bashkëpunëtorët, lexuesit dhe të dashamirët.
Me nderime të sinqerta
Redaksia





Veshja e femrës ilire para 2 mijë vjetëve, që e ruajtën shqiptaret **Shestanesha** deri sot

Sa na duan tjerët

Në bazë të hulumtime*, 20% të qytetarëve të Malit të Zi nuk dëshirojnë të jetojë me shqiptarin në të njëjtin shtet, rreth 25% nuk dëshirojnë të ketë kojshi shqiptarin dhe të bashkëpunojnë me te. Gati 37% nuk dëshirojnë të kenë shef shqiptarin, si dhe 46% nuk dëshirojnë që shqiptari t'i mësojë fëmijët e tij. Nuk dëshirojnë të shoqërohen me shqiptarin mbi 34%, 50% nuk dëshirojnë të jetë shqiptari në post drejtues shtetëror, 53% nuk dëshirojnë martesa me shqiptarë, kurse 63% nuk do të martoheshin me shqiptarë e as do të donin që këtë ta bënin fëmijët e tyre.
*Hulumtimet e Qendrës për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut në nëntor 2013, në 16 komuna të Malit të Zi, 790 të anketuar.
Marrë prej Shqetësuese distanca etnike ndaj shqiptarëve, **KOHA JAVORE** nr 595, 12 dhjetor 2013:4.
Koment (n'gjuhën lokale t'shqypës)
Nuk na kanë faj malazeztë qi nuk na duen. Shum shqyptar shestanas, kranjanë, anamalas dhe malsorë munohen me rrejtë se janë malazez. Populli thotë: *Rrena i ka kamtë e shkurta*. Kurrkush nuk i do njerzit qi nuk e thonë t'vërtetën. **O burra e burrnesha, thone t'vërtetën qi jini shqyptar. Folne dhe duene gjuhën e nanës tuej, gjuhën shqype qi jav lanë t'partë; gjuhën qi ata e ruejten me qina e mija vjet; ta hupni atë gjuhë isht mkat i madh. Kur neroni gjuhën e vet, ju neroni t'partë e vet dhe vetveten, rranxën dhe fisin e vet. Atëherë edhe tjerët kanë me ju nerue dhe kini me mujtë me kërkue t'drejtat e veta, t'drejtat njerzore qi ju tokojnë**

(Përgatiti dhe komentoi S.Gj.Dobreci).

Diçka e kalbët në trevat shqiptare

Keqpërdorimet si me program shkatërrues

Shkruan **prof. Dr. Hysni Hoxha,** Prishtinë

Të këqijat skandaloze në Universitetin e Prishtinës shpërthyen fuqishëm dhe dolën në shesh. Edhe në fusha të tjera, të këqijat janë të pranishme qëkur kontrollin shoqëror e mori politika partiake. Mirëpo, në Universitetin e Prishtinës, sa mbaj mend unë, që punoj më shumë se 30 vjet, asnjëherë nuk ka qenë më e keq gjendja si në ditët e sotme. Më kujtohet si sot, kur para disa vjetësh paraqiti kandidaturën Prof. dr. Muhamet Mustafa, i cili tha: "Po kandidohem, por larg duhet t'i mbajë duart politika!" Mirëpo, pushtetarët e asaj kohe, bashkë me militantët e tyre, përgatiten lojën që në Senat, të mos zgjidhet profesori Muhamet Mustafa, sepse ai do t'ua prishte planet, prandaj ndikuan që në vend të tij të zgjidhet rektor Prof. dr Enver Hasani. Në këtë rast duhet theksuar se edhe Enver Hasani, nuk është zgjedhur në mënyrë ligjore, sepse nuk ka pasur gradë shkencore profesor i rregullt i universitetit. Për këtë emërim të paligjshëm me vend ka qenë reagimi i Prof.dr. Agim Paca i Fakultetit të Drejtësisë ku punonte edhe Enver Hasani.

Gjatë kohës kur ka qenë rektor ky profesor, ka pasur keqpërdorime. Por të këqijat më të mëdha ndodhën gjatë mandatit të rektorit Prof. dr Mujë Rugova, të cilin e emëroi kryeministri Hashim Thaçi. Në këtë kohë janë injoruar tërësisht strukturat udhëheqëse të Universitetit të Prishtinës, me qëllim që më lehtë t'i futin duart korruptuese pushtetarët. Me urdhër nga lart emërohen në punë: asistentë, profesorë që kanë magjistruar dhe doktoruar në mënyrë jo të rregullt. Është tejet brengosës fakti i emërimit dhe angazhimit të kuadrit universitar, të ligjërojnë lëndë, që nuk i kanë profesion. Në Fakultetin e Edukimit, ku unë më 2010 isha i angazhuar, është pranuar agronomi të jepte lëndën Menaxhimi i Shkollave në vend të profesorit me gradën doktor i shkencave pedagogjike.

Para pesë vjetësh në të njëjtin fakultet ku ligjëroja, është emëruar prodekan për çështje financiare personi, që nuk kishte njohuri lidhur me menaxhimin e financave. Siç më informoi një i besueshëm i dekanatit, urdhrin për një emërim të tillë e dha "Vertikalja". Një miku im i besueshëm nga një fakultet tjetër më tha: "Ma sollën asistentin që për herë të parë e pashë". Ai m'u lut të mos ia përmend emrin. Në pranverën e vitit 2010 i thashë Dekanit të Fakultetit të Edukimit dr. Hasan Muja: "Mos merr pjese në shkatërrimin e Universitetit. Respektoni Statutin e këtij institucioni". Prej Dekanëve vetëm Prof. dr. Osman Gashi i Fakultetit të Filologjisë reagoi publikisht para disa vitesh se nuk respektohen strukturat udhëheqëse të fakulteteve". Dekani u përgjigj: "Po ç'bëri?". I thashë se e tha të vërtetën. Po të kishin ngritur zërin shumica e dekanëve dhe e anëtarëve tjerë të Senatit, nuk do të ndërhynte kështu pushteti.



Qëndrimi johuman ndaj profesorëve me pension poshtërues dhe përbuzës

Pas moshës 65 vjeçare profesorët e Universitetit të Prishtinës mbetën si njerëz të degraduar me një "pension" poshtërues, së pari 25 euro, pastaj shumë më vonë me 112 euro. Para 6 vjetësh Dekani i Fakultetit të Edukimit, Prof. dr. Nebi Elezi më tha: "Nuk kemi obligim ndaj profesorëve të pensionuar". Ndërsa unë i thash që keni obligim ndaj studentëve". Në vend të tyre mezi kanë pritur zëvendësimin. Kishte mjaft profesorë të pensionuar, të aftë dhe të gatshëm të ligjëronin në ketë institucion, por ata, si dhe pensionistë të fakulteteve te tjera të dëshpëruar thellë u larguan, pa e siguruar ekzistencën e tyre jetësore. E keqja e madhe është se në vend të tyre sollën në mënyrë jo të rregullt, asistentë, profesorë që ato lëndë nuk i kishin të profesionit të tyre. Përveç pagës enorme që e kanë pa meritë, ata marrin honorar për pesë deri në gjashtë orë mësimi që u është garantuar nga Rektorati i Univesitetit të Prishtinës. Profesorët, të pensionuar, ekspertë dhe me përvojë dhe të aftë për të ligjëruar, mbeten të përbuzur pa siguruar ekzistencën e tyre me pensionin poshtërues. Njoh prej kolegëve të mi që në këtë gjendje vuajnë nga depresioni psikik.

Jo rrallë herë për cilësi në arsim përmendin Perëndimin. Mirëpo atje, në dobi të studentëve dhe shkencës, angazhojnë edhe profesorë mbi moshën 70 vjeçare. Më 2010 rektorit Mujë Rugova solli urdhrin, në të cilin vetëm në dy rreshta shkruhej: "Profesorët që kanë mbushur 70 vjet të mos angazhohen". Një urdhër të tillë e ka nënshkruar Prof. dr. Basri Çapriqi, në atë kohë, Kryetar i Këshillit Arsimor të Universitetit të Prishtinës.

Vlimi i ngjarjeve tragjiko-komike pas aferës së avancimeve më punime pa vlerë në revista korruptive jashtë vendit

Perden e mashtrimeve të punimeve pa vlerë shkencore e hoqi publicisti Besnik Krasniqi i të përditshmes "Koha Ditore". Ai me pseudonim qesharak, Filan Fisteku botoi disa fragmente nga vepra e Marksit dhe Engelsit: "Manifesti Komunist", në revistën "Society for Science and Nature". Fjalët "komunizëm" "proletariat"," parti" i zëvendësoi me fjalët

"minerale", "tregti" "menaxhim". Ky botim u realizua me 80$. Me kritere mashtruese dhe korruptuese janë publikuar tre punime të Rektorit Gashi, dhe punime të profesorëve tjerë të Universitetit të Prishtinës. Për botimin e këtyre punimeve janë dhënë të holla nga buxheti i varfër i Kosovës.



Pas të gjitha këtyre shpërdorime shqetësuese, njerëz përgjegjës të Universitetit të Prishtinës, pa fije turpi, disa duke qeshur, mbrojnë publikisht këtë gjendje. Kështu veproi Prof. dr. Nuri Bexheti, prorektor për mësim i cili ka përgjegjësi themelore për mirëmbajtje të mësimit në këtë institucion i kapluar nga krimi i organizuar, korrupsioni dhe mashtrimet e turpshme akademike. Nuri Bexheti, që ka punuar jo vetëm në ketë universitet, ai që nuk e paraqiti pasurinë dhe për këtë u gjobua, në mjetet e informimit Senatin e quajti të shenjtë, sepse aty e ka përkrahjen e një numri jo të vogël të profesorëve të korruptuar dhe përkrahjen e shtatë studentëve.

Pa përgjegjësi morale dhe profesionale u tregua edhe Ramë Vata, deputet i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Kryetar i Komisionit Parlamentar për Arsim. Ai publikisht deklaroj se revistat në fjalë nuk mund të quhen korruptuese ("Koha Ditore", 31.01.2014). Me të vërtetë, ngjarje tragjiko-komike është kjo që po ndodh në Universitetin e Prishtinës. Mirëpo shumë më tepër ka tragjizëm. Më tepër është për t'u brengosur sesa për t'u qeshur pas sprovës inteligjente dhe të dokumentuar që bëri **Filan Fisteku** i "Kohës Ditore". Tani shtrohet pyetja: A mund të fshihet gjithë ky skandal shqetësues? Do të ishte në interes të Universitetit, Kosovës si shtet, por edhe në interes të kombit që këta njerëz keqbërës të shtrëngojnë gishtin fuqishëm në kokën e tyre dhe ta pyesin veten: Çfarë jemi duke bërë? Ata si të tillë janë përgjegjës për veprimet e paligjshme.

Çfarë është dielli për tokën, është Universiteti për ardhmërinë e një kombi

Keqbërësit që i kanë futur duart në Universitetin e Prishtinës nuk duan të dinë për misionin e këtij institucioni si burim i dijes. Në këtë kontekst po përmend fjalën e urtë, "Çfarë është dielli për tokën, është Universiteti për kombin". Përkundër një mendimi të tillë të artë, Qeveria e Kosovës me militantët partiakë, me përkrahësit e saj, me servilët me pretendime politike, që votojnë për këtë qeveri, po e zë diellin, dritën e diturisë me injorancë, e cila ligjërohet në Universitetin e Prishtinës. Profesori, shkrimtari Ramiz Kelmendi, individë që marrin gradë akademike pa meritë, i ka quajtur jo një herë "doktorë pa shkollë fillore". Profesori i këtij Universiteti, dr. Arben Hajrullahu në emisionin televiziv "Interaktiv" për ngjarjet alarmuese, që po ndodhin në kohën e fundit, në mënyrë figurative u shpreh: "Anija e madhe e qeverisë, po e mbron të mos fundoset anija e vogël e Universitetit". Mirëpo, anija e madhe e qeverisë, bashkë me qeverinë, nga dallgët e rinisë studentore dhe të qytetarëve tjerë, mund të fundoset, prandaj timonierët e saj duhet të ndërgjegjësohen dhe ta largojnë me kohë nga Universiteti, sa nuk është fundosur bashkë me qeverinë.

Rinia studentorë është avangarda që u prin proceseve për transformime demokratike shoqërore. Bashkë me qytetarë të tjerë që tani në këto ditë të vështira po u bashkohen, do të arrijnë synimet e tyre, që janë edhe synimet e kombit tonë.



Fotot na i mundësuan Agron Bajrami, kryeredaktor i gazetës KOHA Ditore, si dhe Durim Hoxha, Prishtinë

Pak humor

KTHIMI

Pas gati tre muajsh gruaja i kthehet burrit dhe i thotë:
-A mund të më falësh që të kam lanë?
-Gjithsesi, po nuk mund të falë që u ktheve!

KUJDESI

Një grua i ankohet burrit:
-Ti më shumë po i kushton kujdes pantallonave sesa mua!
-Ani çka? Pa ty mund të dal në rrugë, e pa pantallona a dilet haptazi?!

NYJA

-Pse e ke këtë nyjë në shaminë tënde të xhepit?
-Ma ka lidhur gruaja ime që të mos harroj ta dorëzoj letrën në postë.
-Po, a e dorëzove?
-Jo. Gruaja harrojë të ma japë letrën!

MARTESA

-Të dashur prindër, kam vendosur të martohem. Kjo do të bëhet me 29 shkurt.
-Pse mu më 29 shkurt?
-Që përvjetorin e martesës ta kremtoj çdo katër vjet.

Shënoi **Shaban Hasangjekaj,** Martinaj, Guci, më 26.10.2011.

Veshja popullore e Krajës

Shkruan Ali Gjeçbritaj

Një nga aspektet e rëndësishme të mënyrës së jetesës janë veshjet popullore të cilat me larminë dhe variantet e tyre pasurojnë trashëgiminë kulturore shqiptare. Kjo është simbolikë e veçantë që dallohet me tiparet e veçanta. Në Krajë bie fjala janë dalluese veshja e Anës së Sipërme dhe e Anës së Poshtme. Emblemë e të pares s'ka dyshim se është veshja e Shestani, veshja e grave. Karakteristikë, në të dy anët është, edhe pse Kraja është zone e thatë, pa ujë të gjallë, veshja e gruas kranjane është e bardhë, karakteristike për gjithë zonën me përjashtim që veshjet e nuseve janë të dekoruara me ngjyra të theksuara të ndritura. Qëllimi i këtij shkrimi nuk ka të bëj aspak me studim, por thjesht një përshkrim i veshjes së gruas kranjane në Anën e Poshtme të saj.

Ashtu si veglat e punës, shtëpitë e banimit, ushqimi etj. edhe veshjet konsiderohen ndër mjetet kryesore të jetës së njeriut, thotë Afërdita Onuzi. Edhe kranjanet sipas moshës dhe kategorisë shoqërore krijuan veshjen e tyre me karakteristikat dhe tiparet e saja. Kur kemi të bëjmë me shtresën shoqërore, fjala është këtu vetëm për stolitë e gjoksit me ar e serm e jo me tipare tjera. Të gjitha veshjet e femrës krajane kanë krijuar një pasuri veshjesh. Ashtu si të gjithë shqiptarët, edhe veshja e grave Krajës zë një vend të posaçëm në trashëgiminë tonë të begatë. Këtë begati në Krajë, në Anën e Poshtme të kësaj krahine shqiptare e populluar kryesisht me shqiptarë të besimit islam, gratë e kanë ruajtur me fanatizëm. Me kohë u krijua këtu veshja popullore, e cila në këto anë është ruajtur dhe trashëguar brez pas brezi nga gratë. Gjë që për veshjen e burrave nuk mund të thuhet. Shijet estetike të përdorura për zbukurim, por edhe mënyra e stilizimit, janë ato që pasqyrojnë veçantinë etnike. I gjithë zhvillimi i veshjeve, edhe këtu është i lidhur ngushtë me historinë e zhvillimit e përgjithshëm ekonomik, arsimor e kulturor tek kjo popullsi, për pasojë edhe me historinë e veshjes karakteristike të Krajës (fjala është këtu për disa zbukurime të cilat kanë pësuar disa ndryshime të vogla e që nuk janë përdorur më parë).


Veshje e anës së poshtme Gruaje, Krajë

Në Krajë veshja e gruas ka tri tipare të saj. Veshja e vajzave, veshja e nuseve dhe veshja e grave të moshuar, plakave.

Veshja e vajzave përbëhet nga këmisha e qepur nga faqelli i bardhë, tpanat (brekët, në Krajë përdoret fjala tlindat) e bardha pa dekorime në kamëza, mangët e bardha të dekoruara me lule të pakta, të veçanta për moshën, xhamadani nga kadifeja e zezë i dekoruar me shirit të hollë të bardh, boçja (përparësja) e lidhur në brez me tojë përreth trupit. Boçja është e bardhë, e punuar nga leshi në tezjeh (vekë). Në brez vajzat vendosin edhe mendil në anën e djathtë me dekorim të ndonjë luleje. Edhe çorapët e vajzave janë çorapë leshi të bardhë. Në gjoks si dekorim vajzat vejnë po ashtu mendilin e bardhë me ndonjë lule në krahun e djathtë. Në kokë mbajnë shami të bardhë që në gjuhën popullore i thonë degermi e bardhë, e butë. Siç shihet, veshja e vajzave të Anës së Poshtme të Krajës është tërësisht e bardhë me përjashtim të xhamadanit.

Veshja e nuses dallon nga ajo e vajzave për nga ngjyrat. Me gjithë atë, edhe këtu mbizotëron e bardha. Nusja, kuptohet ka më shumë zbukurime në veshje kudo ndër shqiptarët. Kraja s'ka si të bëjë përjashtim nga kjo traditë gjithë shqiptare. Nuset në Krajë veshin këmisha me nuanca të ngjyrës së bardhë. Veshja e poshtme, tpanat


Veshje Nuseje, ana e poshtme, Krajë

(brekët) po ashtu të bardha, por kamëzat, pjesa më e poshtme e tyre, janë të qëndisura me gjilpërë, në popull njihen me termin ura, pra tpanat me ura. Në pjesën e më sipërme të kamëzave, mbi ura, tpanat e nuseve dekorohen edhe me qëndisje në gjergjef. Kështu si rrjedhojë del se dekorimi i kamëzave të tpanave janë të stolisura me dy zbukurime qëndisjeje, me grep dhe në gjergjef. Setra e nuseve paraqet karakteristikë të veçantë për këtë kategori të veshjeve së nuses kranjane. Setra është nga kadifeja e zezë e shëndritshme me jaka jeshile ose të kaltërta. Jakat sikur edhe mangët e setrës janë të dekoruara me shirit të bardhë. Edhe pjesët e poshtme të dorëzave të setrës janë me ngjyrë të jakave. Hasen këtu edhe shirita ngjyrës së verdhë të hapur. E gjithë setra e nuses është e qepur dhe e therur me tegela të shpeshtë. Nën setër, nusja vesh xhamadanin e nuses i cili është nga kadifeja e zezë. Xhamadani qëndiset me tertil, stolisur me shirit me ngjyrë të theksuar që i shkon për shtati nuses. Stolisja e kokës së nuses nisë me kavërxhikun i cili është nga mëndafshi i kuq, me dekorime të llojë-llojëshme dhe me thakë e që lëshohet poshtë shpinës si stoli. Kavërxhiku ka edhe kapuçin i cili vendoset në kokë dhe është me ngjyrë rozë. Urat e tij janë të qëndisura me fije të arit. Krahas kavërxhikut, stoli e shpinës së nuseve janë edhe kurdelet, të cilat kanë ngjyra



të larmishme të hapura, ku mbizotërojnë roza, e kuqja, jeshilja dhe e kaltërta e hapur etj. Mbi kavërxhik nusja vendosë degerminë e bardhë nga mëndafshi. Nusja poashtu veshë mangët me ngjyrë të bardhë të dekoruara me ngjyra të larmishme të hapura. Mbizotëron kryesisht dekorimi me ngjyrë rozë dhe qëndisja me tegela jeshil. Pjesë e veshjes së nuses, sikur edhe te vajzat, është edhe boçja, e cila vihet në brez dhe lidhet në ije, me tojë me ngjyrë të hapur. Boçja e nuses është me ngjyra të hapura ku mbizotërojnë e kuqja, roza, ngjyra vjollcë dhe ngjyra tjera të hapura. Boçja e nuses stoliset me fije ari. Ngjyrat e boçes qëndrojnë në pozitën vertikale dhe janë paralele. Stolit e brezit të nuseve janë edhe çevret, (llojë shamie këto të qëndisura) në kënde (qoshe). Ngjyrat e çevres kryesisht janë rozë, ndërsa mendili dekorues i brezit ka ngjyrën jeshile i qëndisur në skaj. Dekorim i posaçëm në veshjen e nuses është hajmalia. Ajo është e dekoruar me pesë ose shtatë grashatarë (në formë monedhe argjendi të vogla) dhe e lidhur me qestekë nga sermi (argjendi). Nuset i varin hajmalitë me qestekë në anën e majtë në qosh të xhamadanit. Hajmalitë hasën edhe në veshjen e nuses çame. Zbukurim tjetër tek veshja e nuses është edhe bazibeni, luan rolin e hajmalisë por nuk e ka formën e saj. Nuset zakonisht veshin çorape leshi me ngjyra të hapura të qëndisura me lule në maje të gishtërinjve. Çorapët janë punuar nga leshi i butë me kërrabëza. Zatën, edhe një këngë e vjetër popullore ndër të tjera thotë: **Ban çarap pak me vrap, nji syze, nji sahat, mu sjellë njer gjashtë sahat, mi marue nji mat-mat (një mot-mot).** Pjesë e veshjes dekorative e fytit të nuseve kanë qenë edhe gjerdanët me rruaza.

Edhe veshja e grave të moshuara, e njohur si veshje e plakave përbëhet nga ngjyra e bardhë. Tlindat janë të bardha. Gratë plaka që nuk janë vejusha kamëzat e brekëve i kanë të dekoruara me ura, ndërsa vejushat jo. Këmisha nga pelhura dhe degermia (shamia e kokës) janë të bardha. Setra e zezë e thethur me tegela por pa zbukurime. Jakat dhe dorezat me shirit të bardhë të hollë, më të hollë se tek setra e nuses. Plaka vesh nën setër xhamadan të zi me shirit të verdhë. Boçja e plakes është e bardhë nga pambuku, ndërsa si dekorim plakat në brez vendosin tojën e brezit një mëndil të thjeshtë të bardhë. Mangët e anterisë së plakës janë ngjyrë misri me dekorime të pakta jo të theksuara. Plaka përdor çorape të zinj leshi.

I gjithë ky bagazh etnografik veshjes së grave në Anën e poshtme të Krajës është punuar në tezjeh (vekë). Karakteristikë e kësaj veshje në të tri moshat është se mbizotëron veshja e bardhë e trashëguar nga Iliria e lashtë, nga fisi ilir Labeat që ka populluar basenin e liqenit të Shkodrës. Duket qartë se pasardhësit e këtij fisi të lashtë ilir janë edhe kranjanët. Këtë e dëshmojnë në Krajë, jo vetëm veshja e bardhë edhe në morte, por edhe simboli i gjarprit i skalitur në gurët e shtëpive në disa vendbanime të Krajës, si në Anën e Sipërme ashtu edhe në Anën e poshtme. Ora e shtëpisë (gjarpri), ngjyra e bardhë e veshjes, mënyra e mbulimit të kokës me shami, si dhe shumë karakteristika tjera janë dëshmi e pamohueshme së kjo trevë është iliro–shqiptare.

Diaspora shqiptare në Itali

Nga katundet Arbëreshe

Shkruan **Angelo Matrangolo**
mësues, ka Firmoza (Cs), Italia

Të shtunë njëzet e pesë të majit, Bashkia e Shën Mitrit i hapu dyert Festivalit (Rasenjës) njëzetvjetor të folklorit e kulturës pir vlerimin të Pakicavet Etnike. Tek anfiteatri të katundit, skollat të shumta të pakicave u gjëndëtin bashkë e me kostumet shumëkulluresh, kënduan e vallëzuan. Mbrëmja qe e shkëlqyer, djemt tanë me muzike e simbole vunë në dukje historín e tyre, bujarín të rrënjëvet. Qëllimi i Rasenjës është ai t'i mbjedh gjithë bashkë e t'i lidhinj në ëmrin të miqësisë e të vllezërisë. Skolla jonë merr pjesë ka tetëmbëdhjetë vjet tek kjo ngjarje, e kjo është e mundur vet pir urtësin e zellin të drejtuesëvet skollor të ndryshëm, çë njéri pas tjetrin gjatë vitravet siguruan mbrënda POF-it realizimin të projekteve çë vë pirpara të zbulosh njetir herë rrënjët të vjetra. Mos të farromi se ndir këta vjet shurbian bashkë me Skollin aq Bashkia sa Familjet, çë vanë ngaherë prapa këtyre protagonistëve të rinj, kudo ata dhanë shfaqje. Tek e njëzeta Rasenjë Skolla e Fallkunarës pati të dytin vend pir më të mirin shfaqje, edhe se kjo njohje nëng i përgjegjet të virtetës: pse ndose komisioni kish gjegjur tifozerín, rezultati do të kish qënë ndryshe.

Marrë prej **revistës online Jeta Arbëreshe**, **nr. 75, viti/anno XII, janar-theristě / gennaio-giugno 2013:3; drejtor** e-mail: **Agostino Giordano** jetarbreshe@libero.it;http:/digilander.libero.it/jetarbreshe; *administrata* Via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia), Kozenca, Italia.

Pashá ditën e fejes's,
Pashá vjetën e martes's,
Pashá t'zitë e gjidh jetes's.

Tha Nika'j Luks Per'Pjetrit Pers Stjeps Markut Çobit, Lukiqos, tash n'Kullomzë, Ulqin, më 15.10.2012.

***

Nji komb qi përbuz traditat e veta vendosë vetëvrasjen e vet
(Ernest Koliqi).

Arbërit e Malit të Zi të sotëm gjatë mesjetës

Shkruan **Prof. dr. Jahja Drançolli,** Fakulteti filozofik, Universiteti, Prishtinë

Burimet historike të kohës e historiografia e mirëfilltë, jo vetëm që i kundërshtojnë pikëpamjet e një pjese të historiografisë tendencioze dhe të instrumentalizuar nga politika e ditës, se djepin e etnosit arbëror gjatë periudhës Mesjetare duhet kërkuar në një zonë të vogël të brendshme malore ndërmjet lumenjve Mat dhe Drin, apo në katërkëndshin hipotetik Tivar – Prizren dhe Vlorë – Ohër, por ato provojnë se shqiptarët gjithmonë kanë jetuar në trojet e veta të sotme të rrudhosura ndër shekuj. Në këtë kontekst është për të vënë re se, **arbërit**, siç quheshin dikur **shqiptarët**, gjatë Mesjetës dhe gjatë shekujve të sundimit turk, aq qenë të pranishëm në pjesët lindore e jugore të Malit të Zi të sotëm (i ndeshim edhe si sundimtar shteti – Koçopari në shek. XII), sa që edhe shkrimtarët e kohës, njerëz të oborrit mbretëror nemanjid, si, G. Camblaku dhe K. Filozofi, e konsideronin shtetin e Zetës trevë arbërore. Zatën edhe vetë Car Dushani, në një kartë të vitit 1349, e konsideronte Zetën si pjesë të Arbërisë. Sipas një dokumenti raguzan, që doli në vitin 1443, Podgorica përfshihet në kuadrin e konceptit Arbëri. Kryezotërinjtë e studiuesit të huaj, që kishin kontakte me këto anë, të gjithë bregdetin malazias e konsideronin pjesë të Arbërisë. Edhe venedikasit, të cilët zotëronin disa qytete bregdetare të Adriatikut Jugor, Zetën e shohin si pjesë e Arbërisë dhe më gjerë. Kështu, një e dhënë që doli nga zyra venedikase më 1440, thotë: "*Budua e Zeta dhe vende të tjera të Arbërisë*". Se arbërit bashkëjetonin si shumicë me sllavët e romanët në të gjitha qytetet bregdetare dhe në prapatokën e tyre, dëshmohet edhe në radhonjtë e Statutit të Kotorrit, Statutit të Buduas dhe në Statutin e Kontesë së Gerbelit (Grbal - prapatokë e Kotorrit). Në hapësirën e trojeve etnike arbërore, gjatë sundimit nemanjid realizoheshin kryesisht edhe kontaktet midis popullatës së ardhur dhe popullsisë autoktone të paromanizuar dhe të romanizuar ose gjysmë të romanizuar. Kjo dukuri vërehej sidomos në trojet veriore të Kosovës e të Malit të Zi, por një dukuri e këtillë nuk solli ndonjë ndryshim të madh në raporte etnike. Nuk solli ndryshim rrënjësor as në raporte kishtare, meqë kisha katolike, që u gjend në kuadër të mbretërisë nemanjide, qëndroi në Tivar, qendër kjo, ku ishte ngritur selia argjipeshkvënore; në Ulqin, si qendër ipeshkvënore; Shas, gjithashtu, qëndër ipeshkëvënore, etj. Është për të vën re se burimet e kohës dëshmojnë edhe për shtrirjen e trojeve arbërore përtej territorit të sotëm të Malit të Zi. Kështu, masat kompakte të arbërve në Kotorr, Raguzë (si dhe në prapatokën e tyre) e Hercegovinë, gjatë shekullit XIII-XV, tregojnë se këtu kishte kudo edhe mbeturina iliro-arbërore autoktone të shkëputura nga bërthama. Së këtejmi, studiuesi i mirënjohur kroat, Milan Shufflay në studimin më titull: Biologie des Albanischen Volsstammes, in Ungarische Rundschau fur historishe un sociale Wissenschaften, 1916 / V, I. 11 – 12, pohonte se vendosja e sllavëve në këto anë, pra edhe në Mal të Zi, kishte rënë si një sëpatë, që i kishte prerë në veri dhe në jug disa degë të trungut dhe i kishte ngushtuar brenda një qarku më të vogël.

Një pasqyrë paksa identike të shtrirjes së trojeve arbërore në troje të Malit të Zi të sotëm ndeshim edhe në dokumente të burimit italian, turk e austriak të shekullit XV-XVIII. Vlenë të theksohet, se derisa defterët kadastralë osmanë (Defteri i Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485) të tipit të hollësishëm riprodhojnë praninë e popullatës arbërore në një hapësirë të gjërë gjatë shekujve në fjalë, dokumnetet italiane e austriake të periudhës së përmendur, pjesën dërmuese të territorit të sotëm malazias e inkuadronin në kuadrin e konceptit Arbëri. Se popullsia dërmuese të kësaj hapësire gjatë shekullit XVII ishte pothuaj arbërore (shqiptare), e provojnë edhe shumë të dhëna, sikur kjo e historianit të madh, Ch. Boethiusit, i cili të gjitha fiset që jetonin në territorin malazias i quan arbërore. Një njoftim pothuajse identik na ofron në vitin 1614 edhe bujari nga Kotorri, Marian Bolizza, në veprën "Relatione e descrittione del Sangiacato di Scutari" Të gjitha këto të dhëna, që u zunë ngojë më sipër e shumë të tjera me përmbajtje paksa identike, arsyetojnë konstatimin e studiuesit kroat M. Shuflaj se: "Mali i Zi në aspektin historik mund të konsiderohet si një fëmijë i paformuar i Arbërisë" (shih: Die Grenzen Albaniens im Mittelalter, në: IAFBI, Munchen- Lejpzing 1916, f. 125 – 127).


Kalaja e Ulqinit ia kalon florinit.
E themeluan ilirët, të parët e shqiptarëve.

Duhet theksuar gjithësesi se i tërë dokumentacioni arkivor i zbuluar deri më sot dhe lënda relevante e zbuluar nga shkenctarët e mirëfilltë dëshmojnë se hapësira gjeografike, që zinin arbërit (shqiptarët) gjatë shekujve deri në shekullin XVIII, por edhe më vonë, nuk është rezultat i shpërthimeve demografike, por i tkurrjes territoriale.

> Na shqiptarët jena me tri fe, por vetëm me nji atdhe
> (Gjergj Fishta)

Ullinjtë e shenjtë po na gëzohën

Republika e Malit të Zi dhe komuna e Ulqinit, me kërkesën e ushtrisë Jugosllave, më 17.01.1978, për nevoja ushtarake, bien vendimin për shpronësim të ullishtës së Valdanosit (sipërfaqja e tokës 937.739 m^2 me 17.825 rranxë ullinj) pa pëlqimin e pronarëve. Për qëllimin që u mor ullishta nuk u shfrytëzua. Ullinjtë e shenjtë u lanë të shkretohen. E pse nuk po iu kthehen pronarëve të vërtetë as deri sot? Me kthimin e ullishtës, jo vetëm pronarët, por edhe krejt Ulqini, krejt Mali i Zi, do të ketë dobi.

Këtu po pasqyrojmë një pjesë të aksionit të ndërmarrë nga qytetarët e Ulqinit dhe sektori civil në hapjen dhe pastrimin e rrugës së vjetër nëpër ullishtën e Valdanosit.

Përgatiti S.Gj.Dobreci më1.4.2014.


Foto: Fisnik Dobreci



Foto: Fisnik Dobreci


Foto: Fisnik Dobreci


Foto: Fisnik Dobreci


Foto: Fisnik Dobreci


Foto: Fisnik Dobreci


Foto: MOGUL

Festa e gështenjave në Krajë



Shkruan Ali Gjeçbritaj

Të shtunën më 16.11.2013 në Krajë u mbajt manifestimi bujqësor, turistik e kulturor "Festa e gështenjave" 2013. Ishte ky manifestimi i shtatë me radhë i këtij lloji që organizohet nga Bashkësia Vendore Ostros nën patronatin e Komunës së Tivarit. Këtë vit manifestimi hyri në Programin e festimeve të Ditës së Komunës se Tivarit. Manifestimi "Festa e gështenjave" ka për qellim ruajtjen dhe kultivimin e frytit të gështenjës, mbrojtjen e trungut të kësaj peme me të cilën Kraja është e pasur, zhvillimin e bujqësisë, pemëtarisë, vreshtarisë dhe blegtorisë në këtë zonë kodrinorë - malore si dhe valorizimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të Krajës. Në të njëjtën kohë manifestimi i Krajës, "Festa e gështenjës" ka rëndësinë e posaçme dhe në ruajtjen e identitetit kulturor.

Që në orët e para të mëngjesit manifestues të shumtë, nga Ulqini, Tivari, Podgorica, Malësia, Shkodra, Tirana etj ia mësynë Krajës. Kolona të gjata makinash turrën për në Ostros nga të dy krahët, nga Shtegvasha e nga Virpazari. Mijëra manifestues e mbushën qendrën e Ostrosit. Koloriti i veshjeve të bukura kranjane, dekorimi i banakëve me prodhime bujqësore e blegtorale vendore, tingujt e këngës shqipe dhe hapat e valles popullore bënë që manifestuesit jo vetëm të kënaqën por edhe të kenë mundësi edhe të blejnë prodhime të llojllojshme bujqësore e blegtorale që prodhohen në këtë trevë siç janë gështenjat, ullinjtë, shegat, fiqtë, qepët, hudrat, lloje të ndryshme të çajit, djathë e prodhime tjera bujqësore si dhe lloje të ndryshëm të peshkut, zënë në liqenin e Shkodrës. Manifestuesit u gostitën me gështenja të pjekura dhe të ziera, petulla me djathë e me mjaltë dhe ëmbëlsira tjera vendore. Edhe dita e mirë me diell dhe e ngrohtë ia shtoi madhështinë festës. Organizatori, gjegjësisht Këshilli organizues më parë i kishte bërë përgatitjet paraprake që manifestimi të shkoj mirë. U bënë të gjitha aktivitetet e domosdoshme që rrjedha e festës të rrugëtoj siç ishte projektuar. Manifestimi u hap në orën dhjetë. Në fillim përshëndeti kryetari i Këshillit organizues, Emro Duraku, njëherit edhe kryetari Bashkësisë vendore Ostros i cili ndër të tjera foli dhe për rëndësinë e organizimit të manifestimit. Në emër të komunës së Tivarit përshëndeti nënkryetari Osman Subashiq i cili vuri në dukje mosinvestimet në këtë trevë me theks të veçantë në furnizimin me ujë dhe infrastrukturë rrugore. Preku ai në fjalën e tij dhe shpërnguljen e të rinjve nga Kraja ndër vite. Në pjesën artistike të manifestimit nxënës të shkollës në Ostros recituan dy krijime letrare për gështenjën. Në gjuhën malazeze publicisti, gazetari dhe poeti nga Tivari, Rajko Joliçiq recitoi një poezi kushtuar gështenjave të Krajës. Më valle të bukura popullore pjesëmarrësit i argëtuan valltaret e shkathta të seksionit të folklorit të shkollës së Krajës, këngëtarët Myzafer Koliqi, Ramazan Islami, Smajl Lika, Mirsad Haxhicani etj. Kënga dhe vallja vazhdoi deri në orët e pasditës.

Në manifestimin e sivjetshëm, për dallim nga të mëparshmit, u organizua edhe panairi i prodhimeve bujqësore e blegtorale, ku dominuan gështenjat, peshku, duhani, ulliri, vaji u ullirit, qepa, djathi etj. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të Agjencisë për ndihmë e zhvillim të Turqisë –TIKA, përfaqësues të Ambasadës së Shqipërisë në Podgoricë, Kryetari i Këshillit Nacional të Shqiptarëve në Mal të Zi, z. Genci Nimanbegu, Mehmet Bardhi, kryetar i LDnëMZ, Kryetari i Komunës së Ulqinit, z. Nazif Cungu, Dr. Bahri Brisku, Dr. Sim Dobreci , profesor Ahmet Osja nga Shkodra dhe shumë përsonalitete të tjera të jetës shoqërore, arsimore e kulturore.

Sponsor kryesor i manifestimit është Komuna e Tivarit, pastaj Organizata turistike e Tivarit, MCM Ulqin, Komuna e Ulqini, NP për veprimtari komunale Ulqin, Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi, ANB Tivar, Hajredin Berjashi, "Gragja Comerc" Ulqin, "Beni Comerc" Tivar, "Curoviq" Ostros, Bastorja sportive "REA", Automat club "Majami", "Ardi" Ostros, "Votra" Ostrso, "Rozafa" Ostros, etj.

Dhe në fund, edhe përkundër vështirësive që Këshilli organizues hasi gjatë punës së tij nga elementet turbulluese të cilët deshën që manifestimit t'i japin ngjyrime politike, kjo për fat të mire nuk ndodhi, në rend të pare duke iu falënderuar punës transparente të Këshillit organizues, që nuk lejoi një gjë të tillë duke i venë detyrë vetës se Festa e gështenjave është festë e qytetarëve të Krajës dhe e gjithë të tjerëve. Zaten kjo bëri që manifestimi të jetë më i suksesshmi deri më sot. Ajo që u synua, ajo edhe u arrit.



QAFA E KISHËS – SPINJË

Shkruan MSc. **Anton Lulgjuraj,** arkeolog

Në krahinën e Malësisë, rreth 3 km larg nga qyteza e Tuzit, në perëndim të fshatit Spinjë, aty ku fillon fusha e Dubraves, pranë rrugës



automobilistike ndodhët rrënoja e Kishës prej nga e ka marrë edhe vendi emrin si Qafa e Kishës sepse aty formohet një qafë në mes malit të Doleqit dhe malit të Bratilës.

I pari që e zbuloi këtë kishë ishte arkeologu austriak Theodor Ippen dhe bashkë më të dhe një mbishkrim. Duken sot në sipërfaqe disa murinjë të mbuluar nga vegjetacioni. Nga përmasat e saj duket një kishë e vogël e rrethuar me varreza**.**

Mbishkrimi i zbuluar nga Ippen, ruhet sot gjysma e tij në Kishën e Shën Ndout në Tuz. Mbishkrimin e plotë Ippen e përshkruan kështu: C C C C C - X - P F - A N D R E - ACOCAR.

Një nga cepat e gurit është e thyer dhe në cepin tjetër lidhet një tjetër gur, çka kuptohet nga një brimë lidhjeje, e pra ky fragment për fat të keq nuk na tregon se çfarë ka qenë kjo rrënojë; lë të kuptohet vetëm që është e vitit 1500 dhe ka pasur të bëjë me një murg. Ngaqë rreth e rrotull rrënojës ndodhen varre dhe kurrizi më i afërt malor, prej nga mund të zbresësh poshtë në fushë quhet Qafa e Kishës, kuptohet që kjo rrënojë me të vërtetë ka qenë një kapelë.

Muri i absidës është i ndërtuar nga gurë të papunuar të lidhur me llaç. Ndërsa një fragment tjetër i murit i cili ndodhët i rrëzuar në mes të rrënojës, duket një mur me gurë të punuar kuadratik të lidhur me llaç, një punim më kualitativ se muri i absidës. Përreth kishës ndodhën shumë varre, të gjitha kanë orientimin lindje-perëndim.


Vorret e kishës


Mbishkrimi latin i kishës

Kisha në Qafëkishë është e ritit katolik dhe na jep dëshmi të rëndësishme për religjionin e krahinës dhe fare lehtë mund të lidhet me urdhrin benediktin të cilët në atë kohë ishin shumë aktiv në Shqipërinë veriore. Sipas gojëdhënave, me ardhjen e pushtuesit turk, kjo kishë shkatërrohet dhe brutalisht vriten kleri i kishës, dhe me ate rast ky vend është mallkuar nga prifterinjtë dhe prej asaj ditë deri në ditët tona ky vend ka ngelur i pabanuar dhe mbi këtë fenomen qarkullojnë shumë legjenda urbane.

Msc Anton Lulgjuraj <kolkini@hotmail.commë>
më 11.02.2014.


Muri i kishës

BUZUKU – numri jubilar 40

Prim. dr Gani Karamanaga*

I përshëndes të gjithë të pranishmit në emër të Bashkimit të krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.

Në vitin 2001 ishim disa intelektual nga Ulqini me miqtë tonë nga Kosova në hapësirat e kompleksit "Holegro", ku u ekspozuan numrat e parë të revistës "BUZUKU".



Kaluan vitet, doli edhe numri 40. Në të gjitha këto vite revista, me shumë vështirësi të daljes dhe botimit, trajton një tematikë shumë të vlefëshme dhe afirmative për popullin shqipëtarë. Më e rëndësishme është që luajti rolin e padiskutueshëm që shumë prej neve të kthehemi nga vetvetja, të mësojmë çka është gjuha shqipe, çka janë simbolet e shqipëtarisë.

"Buzuku" ka ardhur në kohë shumë të nevojshme për këto treva ku shqipëtarët përbëjnë shumicën. Ka arritur qëllimin që të bashkëpunoj edhe me diasporën tonë.

Gjithë kohën ka përcjellë ngjarjet lidhur me kulturën, artin e shkencën, e cila ka qenë pjesa e aktiviteteve të Shoqatave joqeveritare si edhe përcjellja e disa ngjarjeve të rëndësishme për afirmimin e kombit tonë.

Mbyllja e shkollave shqipe në Mal të Zi në vitin 1956 ka pasur efekte shumë negative për disa gjenerata. Kemi qenë të detyruar të mësojmë në gjuhën joamëtare. Kështu, nuk kemi ditur asgjë për historinë, kulturën, artin, shkencën dhe letërësinë e kombit tonë.

Revista "Buzuku" ka merita të mëdha për edukimin e një pjese të shqiptarëve në vend si edhe në diasporë.

Tekstet e botuara në revistën "Buzuku" janë të shkruara në gjuhën e cila është e kuptueshme për të gjithë shtresat intelektuale, por edhe për popullin e thjeshtë.

Revista është marr me ruajtjen e folklorit, historinë, ngjarjet të cilat kanë vlera për emancipimin e njerëzve.

Në vitin 2005 u organizua Tubimi shkencor ndërkombëtar "*Konferenca jubilare 450 vjetori i Mesharit don Gjon Buzukut*" ku morrën pjesë autorët nga Kosova, Shqipëria, Italia, Mali i Zi.Të gjthë materialet u botuan në numrin tematik të revistës "Dija" 3/2005.

Më lejoni që ta theksoj që nismëtari, kryeredaktori dhe barësi i të gjthë aktiviteteve ka qenë dhe është Prof.Dr Simë Dobreci.

Një autoritet fetar prej këtyre treva ka thënë "*ekzistenca, si edhe prezenca e komuniteteve fetare në vendin tonë është si kopështi me lule të lloj-llojshme*". Kjo është njëkohësisht edhe pasuria e jonë.

Kombi edhe feja janë dy gjëra të cilat gërshetohen dhe nuk munden të ndahen. Asnjëra as tjetra nuk janë kundërshtuese për njera tjetrën. Nuk ka simbole si edhe autoritete historike të ndara. Të gjitha ato na takojnë të gjithë neve. Jam i bindur, se edhe ato të cilët mendojnë ndryshe duhet t'i kuptojnë këto fjalë.

Ne nuk mundemi t'i gjykojmë dhe klasifkojmë njerëzit, por mesiguri mund të flasim për veprat e tyre.

Prof.Simë Dobrecit i uroj shëndet . Mirupafshim në 80 vjetorin e tij në verën e ardhëshme.

Në fund, urime për të gjithë festat e fundëvitit

*Fjala e rastit në përurimin e numrit jubilar-40 të revistës BUZUKU; Ulqin, më 28.12.2013.



Revista BUZUKU, arkiv në miniaturë

Dr. Nail Draga*

Në gamën e revistave dhe periodikut në shqip në Mal të Zi, në periudhën e pluralizmit vend të rëndësishëm zënë edhe revista BUZUKU, ku ditë më



parë doli në qarkullim numri jubilar i 40-ti më radhë i saj. Numri i parë revistës BUZUKU është botuar me 28.6.2001, ndërsa i 40-ti me 16.12.2013. Fillimisht revista botohej si organ i Shoqatës Dom Gjon Buzuku, ndërsa nga numri 39 është revistë e pavarur, ku nga numri i parë e deri më tash kryeredaktor është dr. Simë Dobreci.

Është përshtypje e përgjithshme se materialet e botuara në ketë revistë, dëshmojnë qartë se misioni i saj ishte sensibilizimi i popullsisë shqiptare nga Kraja, përkatësisht zona e Shestanit, për të ruajtur dhe ngritur vetëdijen kombëtare shqiptare. Nëse shfletohen numrat e botuar deri më tash, del qartë se është prezantuar një material shumë planesh si nga gjuhësia, folklori, historia, gjeografia, etnologjia, arkivat etj, duke dëshmuar pasurinë e këtij mjedisi dhe popullsisë përkatëse. Në rrethana të ndryshme shoqërore si më parë por edhe tash, popullsia shqiptare e këtij mjedisi ka emigruar, duke u vendosur kryesisht në rrethinë të Tivarit, Ulqinit e po ashtu edhe në Shkodër, Amerikë, Australi etj. Por, varësisht prej vendit ku janë vendosur, ata janë tjetërsuar, duke shkuar drejt asimilimit, ku një dukuri e tillë është e pranishme edhe në ditët tona. Rast tipik është qyteti i Tivarit por edhe rrethina e tij, ku janë duke humbur gjuhën dhe traditën kulturore shqiptare.

Fillimisht, kjo revistë ndonëse është informative, kulturore dhe shoqërore, ka pasur karakter lokal, por me kalimin e kohës, është bërë pothuaj revistë mbarëkombëtare. Në sajë të materialeve të botuara deri më tash, më të drejt mund ta quajmë se është bërë një lloj arkivi në miniaturë. Madje nuk e teprojmë nëse themi se është botuar çdo gjë që ka të bëjë me Shestanin dhe popullsinë e saj, duke ofruar një lëndë më interes edhe për studiuesit e profileve të ndryshme shkencore. Jemi të bindur se në të ardhmen studiues të ndryshëm, kur të shfletojnë revistën BUZUKU, do të gjejnë inspirim për hulumtime të mëtutjeshme shkencore.

Nëse në të ardhmen do të analizohet kontributi i disa personaliteteve nga Ulqini e rrethina në profilet e tyre profesionale, nuk ka dilemë se vend nderi zënë edhe dr. Simë Dobreci. Por ndonëse ai njihet si specialist nga fusha e mjekësisë, në të ardhmen do të njihet edhe si kryeredaktor i revistës BUZUKU. Sepse është merita e tij ekskluzive në mbledhjen, sistematizimin dhe redaktimin e materialeve që janë botuar në këto 40 numra të revistës. Nuk ka dilemë se në ketë aspekt ndihmesë kanë dhënë edhe bashkëpunëtorët si dhe stafi i redaksisë, por puna më e madhe ka rënë mbi dr. Simë Dobrecin, i cili ka arritur me sfiduar edhe rrethanat e pavolitshme shoqërore të kohës.

Ne ketë jubile të revistës ai sot duhet të jetë krenar për punën e realizuar, por edhe ne mburremi, sepse nuk është e lehtë të botohen 40 numra të revistës, pa mbështetje financiare, por e ka realizuar me sukses këtë mision falë donatoreve të ndryshëm, si pak kush në mjedisin tonë.

Andaj, me rastin e këtij numri jubilar, urojmë që dr. Simë Dobreci të na dhurojë edhe numra të tjerë të revistës, duke vazhduar misionin për ruajtjen e trashëgimisë kulturore të shqiptarëve në Mal të Zi dhe më gjerë.

*Fjala e rastit në përurimin e numrit jubilar-40 të revistës BUZUKU; Ulqin, më 28.12.2013.



Revista BUZUKU - përurohet numri 40

Shkruan **Ismet Kallaba**



Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi dhe redaksia e revistës “Buzuku-b”, më 28.12.2013, organizuan në Galerinë e Arteve të Qendrës Kulturore në Ulqin përurimin e numrit 40 të kësaj reviste të pavarur informative, kulturore e shoqërore.
Të gjithë folësit kanë vlerësuar lart rolin e revistës “Buzuku” në ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi, sidomos banorëve të Shestanit, si dhe punën e kryeredaktorit të saj, prof. Dr. Simë Dobreci.
Akademiku Emil Lafe nga Tirana ka thënë se profesor Simë Dobreci bashkë me kolegët e tij i ka vënë një mision dhe rol revistës. “Ky është roli i ndriçimit të identitetit kombëtar, roli i nxjerrjes në pah të atyre pasurive të mëdha të folklorit, të kulturës popullore, të mitologjisë dhe të gjitha pasurive të tjera të botës shpirtërore shqiptare”, ka theksuar Lafe.
Sipas tij, revista “Buzuku” i drejtohet jo vetëm së shkuarës, por edhe së tashmes dhe së ardhmes.
“E tashmja janë hallet dhe problemet tona të përditshme. Këtu janë më të mëdha, më të shumëfishta, që duhet të përballohen për të mbrojtur dinjitetin kombëtar, gjuhën, letërsinë, për të ecur bashkë me pjesën tjetër të popullit shqiptar kudo që është”, ka thënë studiuesi Emil Lafe.
Për dr. Nail Dragën, drejtor i Qendrës Kulturore në Ulqin, nëse bëhet një analizë e periodikut shqip në Mal të Zi, përveç gazetës “Koha javore” e cila del një herë në javë, deri më tash vetëm revista “Buzuku” i ka sfiduar rrethanat e kohës në aspektin e botimit të rregullt.
Ai ka thënë se kjo revistë për nga koncepti, përmbajtja, analiza dhe trajtimi i çështjeve është unike për shqiptarët në Mal të Zi dhe se për këtë, “merita kryesore i takon dr. Simë Dobrecit, i cili nuk ka kursyer kohë, mund, por edhe energji për të sjellë materiale interesante”.
Draga ka theksuar se tashmë e kemi një arkiv prej 40 numrash, i cili do të shërbejë për të tashmen dhe të ardhmen, por “sikur të mos ishte 'Buzuku', shumëçka do ta kishim të humbur”.
Kryetari i Bashkimit të Krijuesve Shqiptarë në Malin e Zi, prim. Dr. Gani Karamanaga, ka thënë se gjatë tërë këtyre viteve të botimit të saj revista “Buzuku” trajton tematika shumë të vlefshme dhe afirmative për popullin shqiptar.
“Më e rëndësishme është që ka luajtur rolin e padiskutueshëm që shumë prej neve të kthehemi nga vetvetja, të mësojmë çka është gjuha shqipe, çka janë simbolet e shqiptarisë”, ka thënë ai.
Karamanaga është shprehur se revista “Buzuku” ka merita të mëdha për edukimin e një pjese të shqiptarëve në vend dhe diasporë, të cilët për shkak të arsimimit në gjuhën jo amtare, nuk kanë ditur asgjë për historinë, kulturën, artin, shkencën dhe letërsinë shqiptare.
Duke folur për qëllimin e botimit dhe konceptin e revistës “Buzuku”, kryeredaktori i saj, prof. Dr. Simë Dobreci, ka thënë se në këtë revistë jemi munduar të paraqesim “kulturën tonë, adetet e traditën, rrënjën tonë”.
“Grumbulluam fakte bindëse që na shestanasit jena shqiptarë, njësoj si kranjanët, anamalasit ose malësorët. Mirëpo, si ulemi ose ngulemi në Tivar ose Podgoricë, shumë shpejt po e humbim gjuhën shqipe të nënave tona, gjuhën e të parëve tonë. Në këtë gjuhë, gjatë shekujve u krijuan këngë të mrekullueshme, shprehje dhe fjalë të urta, të cilat të partë tonë, shqiptarët në Mal të Zi, i ruajtën deri sot”, ka thënë ai.
Vlerësime pozitive për punën e deritashme të revistës “Buzuku” kanë dhënë në fjalët e tyre edhe studiuesi Gjokë Dabaj, kryetari i komunës së Ulqinit Nazif Cungu, shkrimtari dhe mësimdhënësi Ali Gjeçbritaj, profesori Osman Kraja, mjekja Zylfije Duraku dhe Gjergj Perkolaj.
Numri i parë i revistës informative, kulturore e shoqërore “Buzuku” ka dalë më 28 qershor 2001. Deri në numrin 38 është botuar si organ i Shoqatës “Don Gjon Buzuku”, ndërsa nga numri 39 “Buzuku-b” botohet si revistë e pavarur.



Ëndrra e gucianëve u realizua

Shkruan **Shaban Hasangjekaj**

Banorët e Gucisë dhe të vendbanimeve përreth, plot 60 vjet kanë pritur në



kthimin e statusit të komunës. Ëndrra e tyre u realizua të mërkurën, më 26 shkurt të këtij viti, kur vendimin e Parlamentit të Malit të Zi, në atmosferë solemne e kanë përshëndetur gucianët të cilët jetojnë anë e kënd botës, e të cilët me të madhe kanë ardhur në vendlindjen e vet që së bashku me të afërmit të shënojnë fitoren e statusit të komunës.

Gucia prej 26.02.2014 është komuna 23 në Mal të Zi, e kanë vendosur deputetët në Parlamentin e Malit të Zi të cilët kanë miratuar ndryshimet e ligjit mbi organizimin territorial, me çka territorit të Gucisë i është kthyer statusi i komunës. Për kthimin e statusit të komunës së Gucisë kanë votuar deputetët e partive në pushtet, të Partisë Pozitive të Malit të Zi dhe të Partisë Popullore Socialiste. Deputeti i Forcës së Re Demokratike, Genci Nimanbegu, ka qenë i përmbajtur, kurse deputetët e Frontit demokratik nuk kanë qenë të pranishëm në seancë për shkak të bojkotit. Përfaqësuesit e të gjitha partive, duke paralajmëruar mbështetjen ligjit të miratuar, gucianëve ua kanë uruar kthimin e statusit të komunës. Në harmoni me ndryshimet më parë të miratuara të ligjit mbi organizimin territorial, në pranverë njëkohësisht do të organizohen zgjedhjet lokale edhe në Plavë edhe në Guci.



Derisa deputetët në Parlament kanë debatuar mbi kthimin e statusit të komunës, të cilin gucianët e kanë pasur para 60 vjetësh, ata që nga orët e hershme të mëngjesit të ditës që ata e quajnë "ditë për histori", janë përgatitur për kremte e solemnitet që kanë zgjatur gjatë tërë natës e madje deri në orët e hershme të së nesërmes.

Kau (gjedhi) i pjekur në hell, i përgatitur për gostinë e të pranishmëve, ka qenë uverturë e kësaj kremteje madhështore. Lokalet kanë qenë përplot mysafir, të cilët kanë përcjellë TV transmetimin e punës së Parlamentit. Disponimi i qytetarëve dhe fryma festive është hetuar në çdo hap, Gucia ka frymuar me mushkëri të përbashkëta. Për disponim dhe argëtim është kujdesur këngëtari Beki Bekiq, i lindur në Guci, me bendin e vet dhe me vëllezërit instrumentalist e këngëtarë, Rifatin dhe Enverin, që jetojnë në Guci. Kënga dhe vallja në sheshin e Gucisë nuk kanë pushuar gjatë tërë natës.

Kryetari i Bashkësisë Lokale "2 gushti" të Gucisë, dr. Rusmin Llalliçiq, në emër të Këshillit Iniciativ për kthimin e statusit të komunës së Gucisë, të cilit edhe i takojnë meritat më të mëdha për realizimin e këtij projekti, në fjalën e vet të rastit, e përkujtoië historikun e vitit 1954. Atë vit, Gucia me djegien e ndërtesës së komunës ka mbetur pa administrim lokal, e me atë rast është djegur edhe arkivi dhe librat amëz, dhe siç ka theksuar me vendimin e pakuptueshëm dhe të palogjikshëm të pushtetarëve të atëhershëm, Gucia ka humbur statusin e Qendrës administrative, për herë të parë në historinë e ekzistimit të vet, duke iu bashkuar komunës së Plavës.

Ai tha, ndër të tjera se "Plot 60 vjet gucianët kanë kultivuar idenë mbi kthimin e statusit të komunës të Gucisë, me bindje se nuk ka përparim pa ndikim vetanak për zhvillim dhe, ashtu si atë e kanë bërë me shekuj. Numri i banorëve për një dekadë jo të plotë prej 7.500 (në 2003) ka rënë në rreth 4.500 (në 2011), kurse resurset natyrore siç janë bujqësia dhe blegtoria janë zvogëluar ngjashëm". Ai iu falënderua të gjithëve që ndihmuan t'i kthehet Gucisë statusi i komunës.

Për Gucinë edhe KOHA Javore nr 606, 6 mars 2014: fq 5.



Varrezat Misterioze

Shkruan **Anton Pllumaj, Tuz**

Në Vuksanlekaj të Hotit, Malësia e Madhe (pjesa nën Malin e Zi), më 1.02.2014, pata rast të vizitoj varrezat e fshatit, që i kanë fascinuar të gjithë që i kanë parë. Ato janë të periudhës para se Vuksan Leka është rikthyer në pronat e veta dhe vlerësimi i lashtësisë së tyre ndryshon nga 200-800 vjet, por disa i cilësojnë shumë më të lashta. Janë diku rreth 30 varreza të gdhendura në gurë, të larta prej 1 m deri 1.50 m, të kthyera me kokë nga perëndimi.





Gdhendja është bërë në pjesën e përparme dhe të pasme, si edhe në vetë pllakën mbuluese. Në to gjen të gdhendura simbole nga më të ndryshmet, si të femrave të stolisura, me parzmore, kryqe që janë të lidhur me simbole të tjera, kryqi i trefishtë, hëna e plotë, gjysmëhëna, dielli, ylli gjashtëcepësh, rrathë ciklik, trekëndëshi, katrorët, shkop barinjsh, gjarpërinj, element nga bota shtazore dhe bimore, fëmija pa kokë, nëna me foshnje, burri i moshuar, një gdhendje që i përngjan shqiponjës dykrerësh me krahë të ngritur, shpata, gjarpri i lakuar që mbi kokë ka gjysmëhënën dhe diellin apo një rreth që në brendësi ka një lule me gjashtë petale - apo diku edhe tetë, kryqi kelt i formës së iksit, brirët e dhisë mbi kryqin që ka formë të rregullt në gjerësi dhe gjatësi, dua të ceki këtu se pothuaj të gjithë kryqet që paraqiten aty janë të gjatësisë dhe gjerësisë së njëjtë, shkopi i ndonjë prijësi dhe shumë gdhendje në gurët e tjerë, që kërkojnë kohë dhe ekspertizë që të identifikohen dhe të studiohen që më në fund t`i interpretojmë dhe të kuptojmë se çfarë deshën të thonë ata që i punuan, pra çfarë mesazhesh përçojnë.



Do të ishte mirë që këto gjëra, të cilat u përmendën këtu, të studiohen gjithnjë e më shumë dhe njerëzit kompetentë të merren shumë më seriozisht me to, sepse vetë banorët e Vuksanlekajve e kanë bërë shërbimin e tyre më të mirë, duke i ruajtur ato dhe duke u kujdesur për to 200 vitet e fundit, kohë këto kur janë zhdukur shumë elemente të trashëgimisë sonë. Ka ardhur koha që me to të merren organet e specializuara, dashamirëse dhe të zhveshura nga "izmat" joshkencore.

Fjalë të urta e fraza - Plavë e Guci

Buka duhet të pjeket, fjala të matet.
Nigjo dy herë, e fol ni herë.
Fjalën duhet peshua, e pastaj lëshua.
Kafshata e madhe ta zën frymën.
Kosin e prishë uji, burrin e prishë goja.
Mâ mirë ni mik se ni çiflik.
Bija âsht hajni i shpisë.
Gruen nigjo, po mos i beso.
Lisi nuk prehet me ni të rame.
Luga e madhe ta çkyen gojën.
Mos fol me bark, po fol me tru.
Parja âsht syni i shejtanit (djallit).
Kush kursen, e ardhmja e shpërblen.
Vajza për botë, djali për shpi.
Fëmija pa nânë si nata pa hânë.
Shtatin pyll e mendjen fyll.
Kam inat, po s'kam takat.
Të mirës mos i bje me kamë.
E mira shkepon, e keqja fluturon.
Doli fjala e mori dhenë.
Cofi maca, u ngjallën mijt.
Nuk mushet bulera me fjalë boshe.
S'kalohet lumi me ni hap.
Libri âsht arma e të mëçunit.
Magjetorja e din rênin e magjes.
Prindi të rrit, shkolla të ndritë.
Kosin e prishë uji, burrin e prishë huji.
Katuni digjet, po adeti s'prishet.
Ku janë dy vetë, mos u ba i treti.
Në katun të vjetër, s'qitet adet i ri.
Lulja çi s'ka erë, s'ka vlerë.
Dheu i zi, ban bukën e bardhë.
Petku pritet si mas shtatit.
Çka s'ta mushë synin, s'ta mushë as mênen.
Çka t'i bajsh babës, ta kthen djali.
Vesi çi piqet, kurr s'hiqet.
Me gojë fol, me duar mos prek.
S'din rakia se çka asht kadia.
Dhia gjithni e ka synin në mal.
Kush ka dijeni, ka edhe pasuni.

Shënoi **Shaban Hasangjekaj**, Martinaj, Guci



Besa e Konstantinit të Madh

Shkruan **Reshat AVDIU,** Preshevë,

Tash e shumë vite më parë ndër popullatën shqiptare në këtë pjesë të Dardanisë Lindore flitet për Besën e Madhe të Konstantinit nga Nishi (Naissus, Dardania), që ia kishte dhënë motrës së tij Doruntina Naissusit, që e kishte martuar shtatë konaqe larg nga Nishi. Duke e pajtuar dhe ngushlluar se për ç'do motmot do të shkonte dhe të merrte motrën e vet dhe ta sillte në gjirin e saj familjar.
Luftëra dhe hata të mëdha kishin ra atëbotë mbi trojet dardane nga të huajt. Në njërën nga ato beteja të shumta kishte ra edhe vet Konstantini i Madh. E për Doruntinën kishin filluar të zgjateshin, e të zgjateshin, pa kufi stinat dhe motet e mërzisë dhe brengës për vëllanë, nënën për ato fusha dhe lendina të blerta në Naissusin (Nishin) e saj të lindjes.
Ç'do mëngjes pranveror ajo dilte tek ata dy lisat e mëdhenj mbi kodrinë për ta pritur vëllain e saj se mos po i vinte atje nga Dardania e largët me kalin e tij të shpejt si shiqeta. Kot, vëllai i saj nuk vinte se nuk vinte dot, e pastaj, së beshku me qyqet e malit ia fillonte vajit dhe kujës për Konstantinin dhe nënën Helenë e mbetur edhe ajo si qyqe në rrem në fronin e të birit të saj në Mediana* të Naissusit. Edhe nëna e saj e priste të bijën e vet se mos po i vinte sa për ta parë dhe ngushlluar për Konstantinin e Madh. Sytë iu kishin verbuar nga vetmia dhe lotët e ditëve dhe netëve në vijim.
Një ditë si zakonisht përsëri Doruntina kishte dalë tek ata dy lisat e mëdhenj për ta pritur vëllanë e saj. E diku atje larg përtej fushës së gjërë dhe katër maleve shqiptare dukej si nëpër mjegull një kalorës që e ngiste kalin e tij si shiqeta; ai sa vinte ofrohej e ofrohej. Hej! Zemra e motrës së shkretë filloi t'i rrihte, e t'i rrihte, vrullshëm e më vrullshëm saqë donti t'i dilte nga kraharori. Vallë, a mos do të jetë vëllai i motrës?! Po, po Konstandini ishte vet, ishte ngritur nga varri dhe kishte ardhur për ta marrë motrën e tij, dhe për ta çuar në vend **Besën e Madhe Shqiptare**. Doruntina e kishte kuptuar se me vëllain e saj nuk ishte diçka në rregull, s'ishte më ai Kostantini i fuqishëm, që kur qëllonte me topuzin e tij të madh, bënte që edhe bjeshka të dridhej! I vinte erë dheu, sytë i kishte të shteruar dhe të venitur, fytyra e tij dyllë e verdhë, flokët e gjata e të shpupurishura, duart e ftohta si akulli, plisi dhe guna e tij e baltosur, me opinga të grisura. Kështu dukej kalorsi nga Dardania e largët.
Koha ishte të niseshin për atë rrugë të largët të Egnatias për në Naissus. Kur po i afroheshin shtëpisë së vjetër, Konstantini i thotë motrës së tij, hec motra ime, hec përpara, sa ta lidhi gjokun për trungun e Mollës së Kuqe! Nga ai moment Konstantini i motrës, së bashku me erën e fortë që kishte filluar të fryente, e të fryente atë pranverë të vonuar, humbi dhe nuk u duk më!



Konstantini i Madh (272-337)
Imperator 306-337

Doruntina si një verkë mbi valët e detit të tërbuar drejtohet për në votrën e nënës Helenë. Atë të shkretë e gjeti të ulur skaj oxhakut duke vajtuar për të bijën e saj Doruntinën dhe djalin Konstantin Naissusin i vrarë ndër beteja të shumta me bajlozët dhe invadorët e huaj, që vinin atje përtej detit për t'i mësyer këto trojet tona dardane.
Nënë, nënë, jam bija yte Doruntina! O Zot, a mos jam në ëndërr, a mos po tallet ndokush me mua plakën e shkretë dhe të verbër. Jo moj nënë, jo, Konstantini, Konstantini… vëllai i motrës erdhi dhe më mori e më solli këtu! Mbeti pak larg shtëpisë sa për ta lidhur kalin për trungun e Mollës së Kuqe të Naissusit (Nishit).
Jo, e shkreta moj bijë! Konstandini vëllai yt, ka vite që ka vdekur edhe varri i tij gjer më tani është rrafshuar për tokë nga stina dhe moti. Ah, moj e gjora nënë, **Besën e Madhe Shqiptare që nga Troja** jonë e lashtë e gjer më sot nuk po e treti dot dheu as nuk po e thanë dot dielli dhe as nuk po e merr dot dallga e detit… . **Ajo është ngulitur thellë në mendjen dhe shpirtin e ç'do shqiptari, pra edhe Besa, e Konstantin Nassusit (Nishit) do të jetojë, e do të jetojë ndër mote**… !
P.S. *Në vitin 330 e.s, Mbretëresha Helenë vdes dhe varroset në Mediana të Nassusit, në Fronin e të birit të saj, Shën Kostantinit të Madh. Ky vendbanim Iliro-Dardan, gjendet sot mes Nishit dhe Banjës së Nishit, gjegjësisht Ilixhës së Nishit. Helena ishte e një shtrese shumë të ulët, e cila u martua me Konstancë Klorin. Pas kësaj ai u nda nga Helena, pasi u detyrua ta merrte për grua vajzën e Maksimilianit, Teodorën. Kostantini ishte pak i shkolluar dhe ishte peng te Diokleciani dhe Galeri. Në kohën e sundimit të tyre ai luftoi me trimëri.*

(Qershor 2013)

* *Autori është i burgosur politikë, njëherit edhe kryetar i "Shoqatës së Muhaxhirëve" për Kosovën Lindore me seli në Preshevë.*

Thesar i çmuar në zhanrin e biografisë

Shkruan **Ali Salaj**

Shkrimtari, studiuesi dhe politologu i njohur Ndriçim Kulla paraqitet me një vepër biografike shumë të guximshme, por edhe tunduese pasi bëhet fjalë për biografinë e një figure të madhe letrare të njohur botërisht, i cili tash sa vite gjendet një hap pranë Çmimit Nobel. Është kjo biografia për Ismail Kadarenë, të cilën autori Ndriçim Kulla e konsideron si një biografi gjysmë të autorizuar duke marrë parasysh faktin se "Një shkrimtar i tillë (Kadareja) ka arsye për të qenë dyshues ndaj kujtdo që do të guxojë të shkruaj biografinë e tij". Autoriteti i pakontestueshëm i Kadaresë dhe qëndrimi i tij që ndonjëherë është cilësuar edhe kontravers, ngjall respekt por shpesh herë mbart dilema të shumta dhe frikë tek krijuesit, të cilët përpiqen të merren me jetën dhe veprimtarinë e tij letrare. Mirëpo, Ndriçim Kulla si një intelektual i veçantë, i tejkalon këto sfida me sukses duke mos rënë nën ndikimin as të kundërshtarëve të Kadaresë, por as duke u bërë ithtar i verbër i tij. Këtë qasje poeti Primo Shllaku do ta quante "ekskursion në zonën e rreptësisë". Kështu, Ndriçim Kulla, siç e thekson edhe vetë, vuri në një sprovë të vështirë "yllin" e tij duke e shkruar këtë libër që do të mbetet një thesar i çmuar në zhanrin e biografisë, por edhe një literaturë interesante në fushën e letërsisë shqiptare.

Prandaj, në këtë kuadër e konsideroj kënaqësi dhe nder që, më 12.12.2013, Shoqata e Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" e bëri përurimin e këtij botimi cilësor, me aksesorët e domosdoshëm të një shtëpie botuese dinjitoze siç është "Plejad". Me këtë prezantim "Art Club"-i vazhdon misionin e vet në afirmimin e kulturës dhe artit letrar duke i ofruar publikut në Mal të Zi një udhëtim imagjinar nëpër librat më të arritur në hapësirën mbarëshqiptare.



Maratona për Ditën e Flamurit

Shkruan **Ismet Kallaba**

Të enjten më 28 Nëntor 2013 - për nder të Ditës së Flamurit, është mbajtur Maratona e Dytë e Pavarësisë Shkodër – Ulqin. Për ndryshim nga viti i kaluar, kur maratona e kishte nisjen nga Ulqini për të mbërritur në Shkodër, këtë radhë rrugëkalimi i saj ka qenë nga Shkodra në Ulqin.
Ceremonia e nisjes së maratonës u zhvillua në sheshin para Bashkisë Shkodër për të përfunduar para Komunës së Ulqinit.
Ideatorët kryesorë të maratonës, Esat Aloshi dhe Mustafë Bërkani nga Ana e Malit, të cilët jetojnë në SHBA, kishin ardhur sërish sivjet për të marrë pjesë në Maratonën e dytë të Pavarësisë.
Ata u shprehën të kënaqur që nisma e tyre, e përkrahur nga veterani i sportit shkodran, Irfan Domnori, tashmë është përhapur edhe në zona të tjera të Shqipërisë, si dhe atyre shqiptare në Malin e Zi.
Grupit të maratonistëve ulqinakë dhe shkodranë, në edicionin e dytë të kësaj maratone, iu bashkuan edhe shumë të tjerë nga Mali i Zi dhe rrethet e ndryshme të Shqipërisë.
Në një garë më tepër simbolike, e nisur vitin e kaluar me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, duke dëshmuar që sporti thyen kufijtë, fitues ka dalë maratonisti i Klubit të Atletikës "Mornar" nga Tivari, Dragoljub Koprivica.
Maratona është organizuar nga Këshilli Nacional i Shqiptarëve në Mal të Zi në bashkëpunim me Bashkinë e Shkodrës.



Shoqatë që punon shumë



Shkruan **Gabriel Grabanica**

Shoqata "Labeatët" në Tuzin e Malësisë festuan datëlindjen e parë. Në botën që po jetojmë dhe sidomos në vendin tonë është bë traditë që kur bije fjala për të festuar, për të shënuar një përvjetor apo datë të çfarëdo lloji, bejmë tepër zhurmë. Shpesh herë siç thot fjala e urtë e popullit tonë "mizën e bejmë buellë". Kemi rast që këtë gjë ta shikojmë në disa organizata e shoqata në realitetin ku jetojmë dhe veprojmë.

Por për dallim, më bindje mundëm të them së shoqata "Labeatët" punon shumë dhe pa zhurmë. Ata festuan, përkujtuan një vjetorin e themelimit të saj, me një aktivitet të një dite të zakonshme në punën e shkelqyer të ketyre djemëve dhe vajzava të kesaj treve.

Labeatët ishin fis ilir që banonte rreth liqenit të Shkodrës, **për ç'arssye edhe kjo shoqatë e mori emrin.** Ky fis përmendet për herë të parë nga Livi gjatë luftës së III iliro-romake. Bënin pjesë në mbretërinë ilire të Gentit. Qytetet e tyre ishin Shkodra, që ishte edhe *kryeqendra* e mbretërisë Ilire, dhe Meteoni (Meduni i sotëm në Mal të Zi). **Labeatët** prenë monedha në emër të bashkësisë fisnore, sipas tipit të monedhave të mbretit Gent.

I ftuar miqësisht nga anetarët e shoqatës, ftesen e tyre e mora më kënaqësi si një ftesë që vetem tradita malesorë dinë me ba.

Unë sebashku më një mik timin në mengjesin e 1 shkurtit 2014, nga Ulqini u nisëm për ti uruar vllezërit tanë më rastin e 1 vjetorit të punës që me aq fisnikëri e kanë berë gjatë 365 ditëve të punës së tyre.

Siç thash në fillim jemi të mesuar nga shoqatat e ndryshme që veprojnë në trevat tona, që takimin e parë me ta e kanë hallin numër një të fondeve, si nuk po kanë fonde, si nuk po japin, si po mbijetojnë etj etj. Në takim më keta djem dhe vajza malsore nuk hasa në këtë virus shoqatash.

Takimi ishte në një udhekryq të vogël në fshatin VuksanLekaj. Më te mbrri aty kryetari i shoqatës Prf. Luigj Camaj na mirëpriti ashtu siç din vetem mikpritja malesore. Më fjalë dhe pershendetjë tipike malsorçe. Dhe per disa minuta djem e vajza mbushen atë vend, dhe nderkohë mbrrinë edhe miqët e ardhur nga Elbasani enkas për këtë datlindje të parë të shoqatës. Ishin vllëzërit dhe motrat tanë nga shoqata e alpinizmit"AST" më qënder në Elbasan. Pasi që u bashkum të gjithë rreth 32 miq nga Elbasani, ne nga Ulqini dhe malësorët vendas. Stafi i shoqatës Prof. Luigj Camaj, Anton Pllumaj, Anton Lulgjuraj, Mark Junçaj dhe veterani i palodhur i malësisë Z. Shtjefen Ivezaj na uruan mirëseardhje, na treguan se festimi i një vjetorit të shoqatës është një ditë pune dhe një ditë e zakonshme, duke ecur në malet dhe kodrat e zonës per rreth, duke e njohur atë zonë dhe bukuritë arkeologjike, gjeografike, historike, kulturore, duke u infromuar per keto elemente nga njerëz të cilet jo që nuk kishin punë dhe angazhime në jetën e tyrë të perditëshme por ishin bashkuar në këtë shoqatë pikerishtë si persona kompetent të fushave të caktuar të kontribojnë për rizbulimin dhe sjelljen në publik gjithë atë pasuri që kanë ato male dhe ato kodra. E kush më mirë do e bentë këtë spjegim se Arkeologu Anton Lulgjuraj, apo gjeografi Luigj Camaj, si dhe historiani Mark Junçaj. Pra kjo shoqatë dallon nga shumë shoqata sepse nuk është shoqat e vetem pensionerave, nuk është e atyre që të deshtuar në jetë i bashkohën një shoqatë per të mbijetuar, nuk është i atyre që përmes shoqatës arrin deri tek perfitimët ekonimikë duke abuzuar më fonde dhe me bamirës.

Kjo shoqatë dallohej per nga cilësia dhe puna e tyre që në të ardhmën frytet e tyre do të jenë të një niveli të lartë në fushën arkeologjike, gjeografike, historike, kombetare, turistike.

Rruga të cilën e kaloi ekspedita kishte këtë përmbajtje: Rrënxë e Qafës, Shpellë e Marash Papës (në Dolec), Qafë e Kishës, Gropë e Derrit, Kalturk, Lazina, Qafë Ugël, Vuksanlekaj (kulla), varrezat munumentale në Vuksanlekaj dhe Muzeu Etnografik i Malësisë në fshatin Lekaj. Hapsira në fjalë disponon me një numër të madh të varreve tumulave (muranave) ilire (mbi 30).

Në Vuksanlekajt e sotshëm në shekujt e parë të mijëvjeçarit të parë pas Krishtit gjendej stacioni rromak i quajtur Birziminium (Birzumena). Për kët flasin gjurmat e shuměta të objekteve dhe mbetjeve tjera arkeologjike siç janë: Gurët Temela, guri milarë (milëtreguesi), fragmente të rrugës së kalldrëmueme, objekte qeramike, pjesë të shtyllave nga mermeri, armë, vegla pune etj. E veçantë është kisha e Shën Andresë me vjetërsi mbi pesë shekuj në Qafën e Kishës, shpella e Marash Papës në të cilën gjatë sundimit turk shërbente për mbajtjen e meshëve shejte, pasi që pushtuesi kishte rrënua kishën në Qafë të Kishës.

Karakteristikë e fshatit Vuksanlekaj është Kulla shekullore familjare e Vuksan Lekës dhe varret monumentale ende të pastudiuara të Vuksanlekajve. Së fundi, ekspedita përfundoi me vizitën e Muzeut Etnografik të Malësisë në fshatin Lekaj të pronarit Shtjefën Ivezaj.

Duke shpresuar që kjo shoqatë të ketë jetëgjatësi aq sa kanë malet e malësisë, nuk me mbetet tjetër veç të ju them vazhdoni djelmoça dhe shpresojmë që ne nga deti te jemi edhe në ekspedita dhe pervjetorë tjera të shoqatës tuaj.

*U botua edhe në gazetën KOHË JAVORE nr 603, 13 shkurt 2014:18-9.

Agim Gashi

ZGJOHU SKËNDERBE*

O Ti mbreti i shqiptarëve,
O Legjendari Skënderbe,
A ke ndie në botë t´amshueshme,
Përsëri n´robëri i shtrenjti atdhe?

Sot n´këtë tokë poshtrisht ulërijnë,
karpatjanë e muxhahedinë,
Me i shporrë këto hijena,
Atdhe e popull të kërkon ndihmë.

Na e rrënuen bustin e Nana Terezës,
Duan me të rrënue
Ty e Ibrahim Rugovën,
Zgjohu o i Madhi Skënderbe,
Na e shpëto Shqipërinë,
Na e shpëto Kosovën.´

Se ky popull i shkretë ka mbetë,
Nuk ka shtet e nuk ka ligje,
Vuejnë nga bandat liqej e detna,
Vuejnë fusha, male e brigje.

Zgjohu, zgjohu Skënderbe,
Zgjoje edhe Ibrahim Rugovën,
Zgjoji dëshmorët edhe njëherë,
Adem Jasharin ta shpëtojë Kosovën.

Zgjoje Isën e Idriz Seferin.
Zgjoje Shotën bashkë me Norën,
Zgjoje atë Nana Terezën,
Atdheut njëherë t'i vejmë kurorën.

N´këtë janar kur zemra e kombit,
Tue ju kujtue flak po ndrit,
Zgjohu Jusuf, Bardhosh e Kadri,
Ti Rexhep e ti Nuhi.

Zgjohuni e ndalnie vajin,
Që nji komb po qan me lot,
Se ky popull do liri,
E nesërmja s'pritet, po duhet sot.

Ju dëshmorë jeni liria,
U bëtë dhe n'fronte e kufi,
Të vdekur janë t'gjallët e atdheut,
E Arbëria kërkon liri.

Zgjohu pra, o Skënderbe,
Me brigadat plot dëshmorë,
Po shesin dheun edhe ujin,
Para botës na bënë horë.

Eja pra mos u vono,
Ta shpëtojmë çka mund t'shpëtohet,
Si një popull plot kulturë,
Me krenari botës 'i shkohet



Urime e përgëzime Plavë e Guci

Tu gzoftë zemra.
Tu shtoftë hisja.
Të ruajt Zoti.
Të pastë nâna.
Mos të patë syni i keq.
U baft ni katun pej teje.
Ta dhasht Zoti të marën.
Mos të gjetë gja e ligë.
U rritsh me babë e nânë.
Kudo shkofsh u gëzofsh.
Kjoft shêjti me ty.
T'i marrsha të ligat.
Kjofsh faqebardhë.
Zoti ta pritë të keqen.
Të shkoftë puna marë.
Mos të provoftë Zoti.
T'i ruajt Zoti mënt e kresë.
Hallall t'kjoftë gjini i nânës.
Meleqët kjofshin me ty.
E çoftë Zoti në Xhenet.

Shënoi **Shaban Hasangjekaj**,
Martinaj, Guci, më 14.11.2012.

Ali Gjeçbritaj, Arbnesh, Krajë

NJERËZ NË UDHËKRYQ

Në oborr kemi humbur rrugën
S'po e gjejmë dot
Ta na shpije në shtëpinë tonë

O zot në qiell
Që nga lart na shikon
Shpëtoi njrëzit e gjakut tim
Që kanë humbur udhën

Në udhëkryqet e jetës
Kemi humbur drejtimin
Kalojmë në dritë të kuqe
E blerta na ka ikur nga sytë

Ali Gjeçbritaj, Arbnesh, Krajë

U LINDA

U linda në tokat e punura
U rrita me baltën e kësaj toke
Me aromën e mijëra luleve
Që lëshonin aromë jete

U linda me tokën e punuar
U rrita me drithë t'saj
Me freskinë e shpative të Rumisë
Mu freskua shpirti gjithmonë
Me ujët e burimeve të bjeshkës me borë
E kam shuar etjën prore

KOHA E TYRE NUK PERENDON

Ata që i vranë i lanë pa varre
Heshtja nuk paska fund
Ku janë ku shkuan
Vallë një ditë do t'i gjejmë

Eshtrat rënkojnë
Gropat e kafkave njerëzore
Presin sytë të shohin dritë
Qyteza rritët e rritët
Mbi ështrat e tyre

Koha e tyre nuk përendon
Një ditë dielli do lind
Në tokën tonë
Valët e detit
Plisat do ti sjellin në breg

QYQET

Qyqet vezët i bëjnë në foletë e huaja
Jetojnë vetë
Grindën me të tjerët

Qyqet janë të trembura
Ato nuk shihën
Ato dëgjohën
Kënga e tyre është vaji

Qyqet për poshtërsi
Asnjëherë nuk pendohën

Qyqet gjithëmon përqafojnë
Gjthçka të huaj
Janë grabitqare janë hileqare
Kanë frikë nga të vetët

Qyqet pëlqejnë vetën
Pa aq urrejnë tjerët

Qyqet këndojnë
Vetëm me kukamë


Të zgjohemi para lindjës së diellit
Mos të na mujnë qyqet

Luthta e parë botnore

Shqyptari more e ngratë,
Si na'j bore fukaratë,
Si na'j bore, na'j kërdise.
N'atë Berlin u bo meshliz
N'atë Berlin meshliz ish bo:
Me Shqypni nane[1] ç'me bo?
Të shtat kajlat kishin thânë:
Krajlit Nemcës me ja lânë.
Krajli Nemcës u kâ thânë:
Shqypninë n'veti dum mé lânë,
Pse ká kjen tash 500 vjet.
Skender-begu u ká dekë,
Nuk kanë krye me folë vetë,
Unë për 'ta po flas medet.
Shqypnija në veti me metë.
T'gjill[2] Ballkani isht illnuo[3],
Kjo Sërbija n'kâmë u çuo,
I vrau nipin me gjill gruo.
Të tanë Nemcja n'kâmë u çuo,
Letër Sërbit i ká shkrua:
Bonu gati me luthtuo,
Për atë nip qi m'ke vrâ muo,
M'ke vrâ nipin me gjill gruo.
Kjo Sërbija n'kâmë u çuo,
Letër Rusit i ká shkrua:
Të tânë Nemcja n'kâmë isht
çuo,
Po do luthtë me bo me muo,
S'jam i zoti me luthtuo,
Top e pushkë më janë rrenuo,
Dhe asqerin kam pakuo,
Aman Rus e me m'nimuo.
Rusi letër i ka shkrua:
Nisja luthtës e pa u friguo,
Treqin-mi kam me t'i çuo,
Për nji mujsha me'j kaluo.
Allamanja bon gajret,
T'gjill po thret parínë e vet:
Pa nigoni gjenerajla,
Kurrkuj tokën mos ja lshoni,
Mos lshoni tokën për s'gjallë,
Mos i lini Francez nâmë.
Kyj Kajzeri po qet plan,
Njëkshtu planin e ka shkruo,
T'gjill Ballkanin mé faruo,
Për tre muoj e kâ maruo,
Me Turkije isht bashkuo;
Thotë Turkija lum aj-lumi,
E kâ zānë Hinglizin gjumi,
E kâ zānë, kâ râ me fjetë,
Na faroj Belgin e shkretë.
Për dy dit e për dy net
T'gjill dynjaja bon medet.
Mos të kjenke Amerika,
Francezit po'j vinte dita;
Tre miljon asqet kâ çuo,
T'gjill Verdunin ka rrathuo.
Rrinë krjlat, po bjrsedojnë,
Lusin Zotin me ksul n'dorë,
More Zot qi je mi né,
Shiko posht ç'po bâhet n'llé,
T'gjill dynjâja çuo n'né.

1.nane - na, ne, 2.gjill - gjithë, 3.illnuo – hidhërua; Shestanasit thonë *ll* në vend të *dh*.

E shënoi **Kola'j Luk's Macit Luk'Pálit Peconj** (Pecaj, Pecić,18.11.1927-), shestanas prej Salçit, tash n'Mal t' Bardhë, Ulqin, më 24.11.2013. *Përgatiti* S.Gj.D.


Bariu ilir me qeleshe (skulpturë e moçme rreth 2100 vite)


Shqiptari shestanas nga Mali i Zi (foto Marubi)

Luthta e dytë botore

N'atë Berlin foli Hitleri,
Musolinit i vojt haberi:
Merr ushtrinë e boni gati.
Prishi paktin Jugosllavi.
Me Higliz Jugosllavija,
Dy armata i çoj Greqija,
Me'j çuo nimë don Amerika.
Krisi luthta pâ dalë drita;
Me qinru don Jugosllavi,
Pej Belgradit iku krajli.
Nuk pritet kyj Italjani,
Nuk pritet kjo Gjermani.
Luthtë e rreptë bohet n'Shqypni,
Ja ká msy, thonë, Mali Zí,
Me hy mrenë e në Shqypni:
Çka t'jetë fis e gjak shqyptar.
Mos me lânë kun nji për farë,
Nji për bé kun mos mé lânë,
Me marrë Shkodër e Tirânë;
Kyj Sav Pjetri komandar,
S'kish menuo si do t'dal,
Puna e luthta me Shqyptar
Harroj miq e pobratima,
Se t'pa besë i boni shkina
Pobratima me t'pimë gjakut,
T'tanë Malsorë, burra oxhakut,
Me vojnik[1] hyni n'Malsí,
Po pret pleq, e po pret thmí,
Plaçkit gjâ, po llunon[2] grá
E n'besë burra tu'i vrá
Gjithmonë kyj zakon mi shkjá.
Kërdi bohet n'atë Malsí,
Veç pej cubash t'Malit Zí.
Shum pej Hotit i ká grí,
Burra n'zâ e djelm të rí,
Pej Kastratit e pej Shkrelit,
Shum i vrâu tu'j qitë n'Lum t'Cemit.
E sa Grudë, Triepsh, Këlmenit,
T'vramë po gjinën në çdo ven,
Çka kje burr qi râ n'dorë t'tí,
S'i la mâ m'u kthye n'shpí,
Shum tu'j vrâ e shum tu'j grí.
Nërmjet hypi Italija,
Kundërshtim s'boni Malsija.
Met Sërbjani e Cërrnagori,
Dhetë për nji u pagu Malsori.

1.vojnik – ushtarë, 2.Shestanasit thonë *ll* në vend të *dh*.

E shënoi **Kola'j Luk's Macit Luk'Pálit Peconj** (Pecaj, Pecić,18.11.1927-), shestanas prej Salçit, tash n'Mal t' Bardhë, Ulqin, më 24.11.2013. *Përgatiti* S.Gj.D.

Aj qi neron gjuhën e vet, aj neron vetveten, familjen e vet dhe t'partë e vet, rranxën e vet e komin e vet (S.Gj.D.).

***

Shqiptarët që e kanë mendjen e kthjellët, duhet të kenë turp të përdorin fjalë të huaja kur flasin shqip
(Faik Konica). *Zgjodhi* Fisnik Dobreci

Atje posht nër ato thana

Atje posht nër ato thana
Rrinë dy motra si dy zana
Kush i ka he mos i pastë
Që si le me dalun jashtë
Jasht e jasht deri në lamë
Ç'po i shkelqejshin njata dhamë
Ma fal nji ta baj gjylpanë
Të qepi jeshil dallamë
Jeshill dallamë me kolla
Hejde piqemi te molla
Te molla te zerdelia
Ku t'u vuer hajmalia
Hajmalia fetë e fletë
Lum ku duheshin dy vetë
Kush munoft o me i da
Mos pushoftë o tue kja
Sikur shiu tue ra
Shiu pushon kanjiher
Mos pushofsh dimër as verë
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.

Nji ditë heret kur u çova

Nji ditë heret kur u çova
Marr çarapin e lëshoj delet
Sidomos tash pi pranveres
Dranafilja del ma heret
Kah mas qarrit i mallova
Në pushim ula pushova
Aty vjen nji djalë i ri
-Marshalla moj çabaneshë
-Sytë t'lumshin djalo tuj qesh
A je për gjithë ditën- o
-Unë për ditë se jo veç sot
Tash sa ditë e tash sa mot
Njisajt gjindem dje e sot
-O ti vashë e bukur- o
Gjithë këta dvetje pse m'i ban
Unë st'kam dvet për politikë
Por me ba nji m'sheh dashni
Kurrkush gja o mos me dijtë
Se me dijtë baba e nana
Dije mirë se na del kanga
Me ba me'm'ditë babë e nanë
M'dripton plumbi anë për anë.
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.

Dy të mirat në nji mëhallë

Dy të mirat në nji mëhallë
Kanë çardaqet ballë për ballë
Ditë e natë rrihen me fjalë
I thot jaranat ti kam marrë
Jaranat s'mush me mi marrë
Se i kam mildanat n'arkë
Qepur me tela të shpesht
E t'mërthyem me sadef.
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.

Hypi hoxha në minare

Hypi hoxha në minare
Veshta nanë se kush ka dekë
Paska dekë nji vajzë me halle
Njaja nanë qe deshta vetë
M'i qit nanë pektat e reja
Mi qit nanë se due mi veshë
Du mi vesh me dalë ka dera
E me nej n'at gur të shkret
Due me nej n'at gur të shkret
Me i shi lotët me faculetë.
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.

T'gjithë për ne po bisedojnë moj fellanxe

T'gjithë për ne po bisedojnë
moj fëllanxe
Ata thonë e mirë po thonë
moj fëllanxe
A çohna e ju lëshojmë
moj fëllanxe
Ju lëshojmë po ku do t'shkojmë
moj fëllanxe
Njitna n'mal e presim land
moj fëllanxe
Po me çka do ta rrethojmë
moj fëllanëze
E rrethojmë me marangjyl
moj fëllanxe
Penxheret me drandafil
moj fëllanxe.
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.

Moj e mirë qi rri në kodër

Moj e mirë qi rri në kodër
Po t'thonë shoqet je ma e vogël
Ma e vogel ani se jam
Njesha shallin për mejdan
Për mejdan për hijeshi
Mu plasë zemrën djelmëve t'ri
Djelmëve t'ri ju ka plasë zoti
Qysh se nuk martohen si moti
Ditë e natë gjinen të kroni
Ne at kronin n'breg të malit
Po çon era tym duhanit
Tym duhanit, duhan skuqit
Nji kuti letra munashit
Ata vijnë o pej dugashit
Prej dugashit prej Ulqinit
Nepja dorën ktij jetimit
Çka do ti jetim i shkret
N'prehen tan unë due me dekë
N'prehen tan unë ndrrosha jetë.
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013

Moj e mirë qi rri në shkam

Moj e mirë qi rri në shkam
Larg ta njeva zanin tan
Ka ma ke maj njat jaran
S'isht jaran por t'vet e kam
Vetë po vjen se unë s'po i tham
Vetë po vjen me nejtë me mue
Perpjecinë i ka qillue
Për me ardhëme nej me mue
Nji par caruqe i ka captue
Dy tri par nuk janë asgja
Se me m'dasht s'mujta me t'ba
Tregoi Naxhija e Muha Salë Nasufit e shoqa e Selim Isejn Cafit, Priftaj, Arbnesh, Krajë. *Shënoi* Ali Gjeçbritaj, më 2013.


Kraja prodhon gështenja të mira si dhe ruan folklorin

Foto Fisnik Dobreci

In memoriam



Nikolla Nilloviq
12.8.1937- 06.12.2013

Nika i Stjepës Zefit (Nikolla Nilloviq, Nilonj) nuk i qindroi sëmundjes. Fati i kishte rezervuar që të ndërrojë jetë më 6 dhjetorit 2013, në Bern të Zvicrës. La mbas vetit të shoqen Marijen, djelmtë Stevon e Gjokën me familje. Familja Nilloviq ka humbur një bashkëshort, prind dhe një njeri të shkëlqyer. Nikolla atyre do mungojë shumë. Por, ai do i mungojë anembanë të gjithë atyre që e donin në Braticë, Ulqin, Bern. Ulqini humbi një nga zërat më të mirë që e përfaqësonte këtë qytet jo vetëm në Zvicër, Mal të Zi, Kosovë.

Kam qenë me fat që pata mundësinë ta njihja gjatë kohës sime kur punojsha në Zvicër e sidomos kur ishim bashkë gjatë pushimeve verore në Ulqin. U trishtova shumë kur mora vesh se Nikolla ndërroi jetë. Miku im Nikolla do të më mungojë shumë, sepse humba një shok, njeri të mire. Bashkë mendonin se pragmatizmi është mënyrë jetese. Nuk do kem më mundësi të debatoj me mendjen e tij të mprehtë. Do më mungojnë fjalët e tija bindëse, të drejta, të urta dhe aftësia e tij për të vlerësuar drejtë jo vetëm njerëzit por edhe gjërat dhe dukurit.

Në jetën e tij, Nikolla ia doli t'i përballojë me dinjitet të gjitha krizat duke jetuar mes Braticës me nënën dhe babain derisa ishin gjallë dhe Zvicrës ku punonte, edukonte dhe shkollonte fëmijët. Ia doli që të vlerësohet si punëtor i shquar, njeri i pjekur dhe i vetëdijshëm, që arriti suksese dhe u bë personalitet shembull për shumë njerëz.

Nuk arrita që sivjet gjatë pushimeve ta takoja edhe një herë. Nuk pata mundësi dhe fuqi t'i shoh momentet e fundit të jetës së tij. Dhe për këtë si ndëshkim më ngeli barra të ndahem prej tij në heshtje në ceremoninë e varrimit në Braticë, ku nga çasti në çast shpresoja se do ta shoh Nikollën prapë në këmbë, gjithnjë në krye të tavolinës në ballkon, me pamjen e tij të vendosur e të hijshme, me buzëqeshjen e tij të rrallë. Por, kur e pash të gjithë ata njerëz që kishin ardhur për të përcjellë në shtëpinë e fundit të tij, u pajtova me të vërtetën se është kjo një humbje e madhe për të gjithë, por i bindur se personaliteti i Nikollës për të gjithë do të jetë gjithmonë impuls dhe forcë, një zë i dashur, që do të mbese mik i përjetshëm dhe babë i pazëvendësueshëm.

Shkruan **Bashkim Hisari**, Prizren, ish diplomat në Zvicër

Edith Durham për ballkanasit*

Cërnojeviqët në dokumentet e vjetra janë quajtur gjithashtu Gjurasheviq dhe për ta është folur në një mënyrë të tillë sa të nënkuptohet se prejardhja e tyre, së paku pjesërisht, ishte shqiptare.

Më 1403, raguzianët i drejtuan Nikollë Topisë, një nga krerët shqiptarë, një letër...: “Kapitenëve tanë u janë dhënë fuqi të plota që të bëjnë lidhje me Gjurasheviçin dhe shqiptarë tjerë.”

Më 1404 shohim të përmendet “Cernoviqi i quajtur Gjurasi”...mënyrë e qartë shqip...

Cërnojeviqët, duke qenë në “gjak” me Balshajt, Gjergj e Llesh Cërnojeviqi në fillim u bënë miq me Raguzën (Dubrovnik). Pastaj, ata hynë në shërbim të Stefan Lazareviqit, të birit të Car Lazarit, i cili sundonte në këtë kohë atë çfarë kishte mbetur nga Serbia nën sovranitetin e turqve, kurse me vdekjen e tij, hynë në varësi të Venedikut. Gjergj Cërnojeviqi kishte tre djem, Gojçinin, Gjurasin dhe Stefanicën. Këta hynë në grindje me serbët dhe u rreshtuan përkrah Venedikut dhe Raguzës kundër Gjergj Brankoviqit, sundues i Serbisë pas Kral Stefanit dhe u përpoqën të merrnin tokat nga ai.

Lidhur me grindjen që plasi shpejt midis tre bijve të Gjergjit, neve na intereson vetëm fati i Stefanicës. Në fillim, ai ishte aleat me Dukë Stipanin e Hercegovinës; pastaj i venedikasve; më vonë, për pak kohë, i Gjergj Brankoviqit të Serbisë dhe, më në fund, si njëri nga aleatët më besnik të Venedikut, ishte Kapiten dhe Vojvodë i Zetës, si shërbëtorë i paguar i republikës së Venedikut.

Stefanica zotëronte si “bashtinë” të trashëguar tokat midis gjirit të Kotorrit dhe liqenit të Shkodrës. ...ai kufizohej me fiset shqiptare, me të cilët... mbante marrëdhënie më të mira se me serbët...u martua me motrën e të madhit Skënderbe dhe, megjithëse ishte më i vogli i vëllezërve, arriti të përvetësonte të gjitha tokat e vëllezërve të tij.

Në vitin 1465, në vend të tij erdhi i biri, Ivani. ...Kur turqit e sulmuan Shkodrën (1474), Ivani ...i shkoi në ndihmë dhe po kështu bëri edhe **fisi shqiptar trim i Hotit**, që përmendej si një nga fiset më të shquara për trimëri. Është një gjë e trishtuar, në të vërtetë, që ky fis trimash me një të kaluar heroike, iu dorëzua pa mëshirë sundimit sllav nga ana e Fuqive, më 1913, me gjithë lutjet e tyre këmbëngulëse.

Mbas një rrethimi të gjatë, Shkodra ra. Ivani bashkë me një numër sllavësh e shqiptarësh kaloi në Itali... kaluan 2 vjet...sulltan Mehmet II vdiq, bijtë e tij luftuan për fronin...një përpjekje për të hequr qafe pushtetin turk nuk u bë...vetëm se Ivan Cërnojeqi dhe Lekë Dukagjini (udhëheqësi shqiptar) të dy...u kthyen në vendet e tyre. Ivani kërkoi ndihmë nga Venediku, por nuk iu dha. Ai pranoi të bëhet vasal i Turqisë, u bë Ivan Beg. Vdiq më 1490. Mbas tij erdhi Gjergji, por mbas një kohe turqit e detyruan të ikë në Venedik. Më 1500 u kthye, kurse turqit i dhanë toka në Anadoll, ku ai edhe vdiq. Afërsisht në këtë kohë vendit iu dha emri “Mali i Zi”. Në hartat e vjetra kjo krahinë shënohet si pjesë Shqipërisë.

*Edith Durham, Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve, Arbëria, Tiranë 2009:fq 53-57 (Këtu b**ëhet fjalë për shënimet në çerekun e parë të shekullit XX, e sidomos më 1908**).

Ndihmuan revistën 'Gjon BUZUKU'
(Renditja si mbas abecedës)

Fatmir Kelmendi, Prishtinë-€10.
Dr Hasan Beqa, Prshtinë-€50.
Stjepa e Gjoka'j Niks Stjepës-familja Nilonj (Nilloviq), Braticë, Ulqin, tash n'Bern, Zvicër-€100.

Për shumot Pashkët

Shqiptari në Librin e Ginisit

Përgatiti **Gabriel Grabanica**

Autoritetet e Librit të Ginisit kanë certifikuar veprën gjigante “Mozaiku i Vlerave” të realizuar nga Don Dominik Qerimi. Lajmin e ka



konfirmuar për KultPlus, autori i kësaj vepre i cili është prift katolik dhe drejtor i Qendrës "Don Bosko" në Gjilan. “Mozaiku i vlerave”, përbëhet nga 51 mijë e 865 boça të pishave, të cilat janë mbledhur në një periudhë prej katër vitesh.. Kjo vepër është e gjerë 15 metra dhe e gjatë 7 metra ndërsa në të janë portretizuar figura e humanistes Nëna Terezë, Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Don Bosko.

Autori i veprës madhështore “Mozaiku i Vlerave“ Dom Dominik Qerimi është njoftuar sot, se më 06 janar 2014 zyra përkatëse e Guinness World Records në Londër e ka shpallur si rekord të ri botëror veprën e tij madhështore të realizuar nga boçat e pishave.Lajmin e ka bërë të ditur vetë autori i cili ka deklaruar se ceremonia zyrtare e dorëzimit të çmimit nga ana e autoriteteve të Guiunness World Records do të mbahet më 8 shkurt në Qendrën “Don Bosko” në Gjilan. “Unë nuk jam artist! Unë jam thjeshtë: I DASHURUAR NË JEZUSIN! Gjithçka që JAM dhe BËJ, është thjeshtë fryt i kësaj DASHURIE!” ka thënë përmes facebook-ut autori Dom Dominik Qerimi.

Qerimi është prift katolik i lindur më 1971 në fshatin Janosh të Gjakovës dhe aktualisht është drejtor i Qendrës “Don Bosko” në Gjilan.

Çertifikimi i “Mozaiku i Vlerave” ka kaluar një proces të verifikimit prej datës 26 dhjetor 2013 kur janë dërguar të gjitha dokumentacionet dhe materialet e nevojshme pranë zyrës Rekordit Botëror të Ginisit.Vepra ka hyrë në kategorinë e re të krijuar enkas për këtë mozaik me titull 'Largest pine cone mosaic' (Mozaiku më i madh në botë me boça pishash), me numrin e regjistrimit ID: 437233.

“Mozaiku I vlerave” është realizuar për 53 ditë pune ndërsa për mbledhjen, seleksionimin dhe pastrimin e boçave i kanë ndihmuar të rinjtë vullnetarë të Qëndrës “Don Bosko” në Gjilan.

Vepra është përuruar më 21 dhjetor të vitit që lëmë pas në mjediset e Teatrit të Qendrës Edukativo-Sociale “Don Bosko” në Gjilan.

Me rastin e përurimit autori kishte deklaruar se madhështia e këtij mozaiku le të jetë nxitje që shikimet e njerëzve të drejtohen për t'u definuar me cilindo term njerëzor, e siç është shprehur ai, kjo është dashuria ndaj Zotit.

“Një ndër karakteristikat që njeriu veçohet nga krijesat e tjera, është edhe fakti se njeriu nuk jeton vetëm nga ato që i plotësojnë nevojat dhe prirjet e tija fizike, por edhe nga nevojat dhe prirjet e tija shpirtërore, ndër të cilat mund t'i radhisim vlerat dhe virtytet. Andaj ky mozaik quhet “Mozaik i vlerave”, sepse ka për qëllim që të na bëj të dashurohemi dhe të na edukojë shpirtin në ato vlera, universale, kombëtare dhe lokale”, ka thënë Don Qerimi.

KultPlus ka raportuar më herët për realizimin e kësaj vepër madhështore. Në linqet e mëposhtme mund të njiheni më shumë lidhur me shkrimin e realizuar me rastin e përurimit si dhe albumin e fotografive të kësaj vepre madhështore.



Foto: Arbër Dobreci